

1 E mërkurë, 20 prill 2022

2 [Seancë e hapur]

3 [I akuzuari hyn në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.30

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zonja  
6 Sekretare ju lutem paraqitni lëndën.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar  
8 Gjykatës. Kjo është lënda me numër KSC-BC-2000-05, Prokurori i  
9 Specializuar kundër Salih Mustafës.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
11 Faleminderit, znj. Sekretare.

12 Mirëdita të gjithëve. Së pari, u kërkoj të pranishmëve të  
13 prezantohen.

14 Znj. Prokurore ju lutem na thoni kush është i pranishëm  
15 për Prokurorinë.

16 ZNJ. SILVIA D'ASCOLI: [Përkthim] Mirëdita. Zyra e  
17 Prokurorit të Specializuar përfaqësohet sot nga  
18 Ndhmësprokuror Filippo De Minicis; Menaxherja e Çështjes  
19 Julie Mann; Stazhiere, Mia Vuković; dhe unë Silvia D'Ascoli,  
20 Ndhmësprokurore.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
22 Faleminderit.

23 Mbrojtësja e Viktimave keni fjalën.

24 ZNJ. VOSENBERG: [Përkthim] Mirëdita të nderuar Gjykatës.  
25 Mirëdita të gjithëve. Viktimat pjesëmarrëse përfaqësohen sot

1 nga unë, Brechtje Vossenberq, Bashkëmbrojtëse.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Faleminderit.

4 Avokati i Mbrojtjes, keni fjalën.

5 Z. VON BONE: [Përkthim] Mirëdita, e nderuar Gjykatëse,

6 Mbrojtja sot përfaqësohet nga Bashkëmbrojtësi, z. Betim Shala;

7 unë, Julius von Bone; përkthyes dhe hetues z. Fatmir Pelaj;

8 dhe i pranishëm në sallë është dhe z. Mustafa, i akuzuari.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

10 Faleminderit. Për procesverbalin, ky proces zhvillohet pëprara

11 Trupit Gjykses I.

12 Sot do të dëgjojmë dëshminë e dëshmitarit të Mbrojtjes

13 1300, z. Musli Halimi.

14 U lutem të shoqëroni dëshmitarin të hyjë në sallën e

15 gjyqit.

16 [Dëshmitari vijon dëshminë]

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

18 Halimi, mirëdita. Mirë se erdhët në Dhomat e Specializuara. Më

19 dëgjon mirë?

20 DËSHMITARI: Po.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë

22 mirë. Së pari, si jeni?

23 DËSHMITARI: Mirë. Mirë.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë,

25 faleminderit, z. Halimi. Sot do të fillojmë me dëshminë tuaj.

1 Ju kanë thirrur të dëshmoni përpara Dhomave të Specializuara  
2 në çështjen gjyqësore Prokurori i Specializuar kundër Salih  
3 Mustafës, për ta ndihmuar Trupin Gjykses të marrë një vendim.  
4 Pasi të keni bërë deklaratën solemne do t'ju bëjë pyetje  
5 avokati i Mbrojtjes, që është ulur në të djathtën tuaj. Pastaj  
6 nga përfaqësuesit e Zyrës së Prokurorit të Specializuar dhe  
7 nga Mbrojtësja e Viktimave dhe në fund mund t'ju bëjmë pyetje  
8 edhe ne, anëtarët e Trupit Gjykses. E qartë?

9 DËSHMITARI: E qartë. E qartë.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë  
11 mirë. Dëshiroj t'ju jap disa udhëzime se si t'u përgjigjeni  
12 pyetjeve të cilat do t'ju bëjnë.

13 Ju lutem, z. Halimi, dëgjojeni me kujdes secilën pyetje.  
14 Nëse nuk e kuptoni lirish mund të kërkoni që pyetjen t'ju  
15 përsëritim. Dua të na tregoni të vërtetën, të na tregoni se  
16 çfarë keni parë, çfarë keni dëgjuar, çfarë keni përjetuar  
17 çfarë keni ndier ju vetë. Nëse e keni zbuluar në ndonjë mënyrë  
18 tjetër, na e thoni.

19 Mund të mos ju kujtohen të gjitha hollësitë e ngjarjeve.  
20 Nuk ka problem për këtë. Ju lutem, dëshmoni vetëm për atë sa  
21 mbani mend. Nëse e dini apo nuk ju kujtohet, na e thoni kështu  
22 "Nuk e di" apo "Nuk më kujtohet".

23 Ju lutem përgjigjuni vetëm pyetjeve nëse ka nevojë për  
24 sqarime do t'ju kërkohet sqarimet pastaj. Mund t'ju ndaloj  
25 nëse mendoj se po i shmangeni apo po devijoni nga pyetja, për

1 të cilën duhet të jepni përgjigje.

2 Ju rikujtoj se mund të refuzoni t'u përgjigjeni pyetjeve  
3 të cilat mund t'ju fajësojnë.

4 I kuptuat të gjitha këto z. Halimi?

5 DËSHMITARI: Po.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë  
7 mirë. Dëshiroj t'ju jap tani disa këshilla praktike për  
8 dëshminë.

9 Z. Halimi gjithçka që themi këtu përkthehet dhe  
10 regjistrohet, prandaj dhe është e rëndësishme të flisni pranë  
11 mikrofonit që keni përpara, të flisni ngadalë dhe të flisni  
12 qartë. Kjo u jep mundësi përkthyesve që të përkthejnë gjithçka

13 Duhet të filloni të flisni vetëm pasi të ketë mbaruar  
14 personi që jua bën pyetjen. Mbasi t'jua bëjnë pyetjen numëroni  
15 me vete deri në pesë. Mund të duket si një gjë paksa  
16 artificiale sepse njeriut u vjen që të përgjigjet menjëherë,  
17 siç e kemi parë edhe më përpara në këtë proces. Por unë ngul  
18 këmbë, numëroni me vete deri në pesë dhe pastaj përgjigjuni  
19 pyetjes. Sepse kjo pauzë prej pesë sekondash është e  
20 rëndësishme për të gjithë ne që të dëgjojmë dhe të ndjekim siç  
21 duhet ato që thuhet. Sepse përndryshe ka mbivendosje të  
22 folësve dhe përkthyesit të cilët janë të ulur në kabinë, nuk e  
23 përkthejnë dot siç duhet gjithçka që thuhet.

24 Nëse unë do të ngre dorën, ju lutem në atë moment, duhet  
25 të mos flisni më. E bëj me dorë, pra e ngre dorën sepse nuk

1 dua që të flas, sepse për ndryshe ka mbivendosje të folësve.

2 Ndonjëherë do t'ju kërkojmë që të hiqni dëgjueset apo do  
3 t'ju kërkojmë që të dilni nga salla për shkak të gjërave që  
4 duam të diskutojmë dhe për të cilat nuk duam t'ju  
5 influencojmë.

6 Nëse do të keni pyetje, nëse keni nevojë për pushim apo  
7 nëse keni nevojë për diçka tjetër, mjafton të ngrini dorën dhe  
8 unë do t'jua jap fjalën në mënyrë që të na thoni se për çfarë  
9 keni nevojë. Në rregull? I kuptuat të gjitha këto? Vërej që po  
10 pohoni me kokë.

11 DËSHMITARI: Po.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për  
13 procesverbalin po e them unë me fjalë që jeni dakord, se  
14 shenja e kokës nuk shënohet në procesverbal.

15 Pyetja e fundit, a e flisni anglishten z. Halimi?

16 DËSHMITARI: Jo.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] OK.

18 Faleminderit. Siç veprojmë me çdo dëshmitar, do t'ju kërkoj  
19 tani që të lexoni deklaratën solemne për të thënë të vërtetën.  
20 Ju rikujtoj se përbën vepër penale brenda juridiksionit të  
21 Dhomave të Specializuara dhënia e dëshmisë së rreme.

22 E kuptoni këtë?

23 DËSHMITARI: Po, po.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.

25 Asistente e sallës, vërej që ja keni dhënë tashmë tekstin

1 dëshmitarit me deklaratën solemne.

2 Z. Halimi, ju lutem lexoni tekstin që jua kanë vendosur  
3 përpara.

4 DËSHMITARI: I ndërgjegjshëm për rëndësinë e dëshmisë time  
5 dhe përgjegjësisë time ligjore deklaroj solemnisht se do ta  
6 them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe vetëm të vërtetën dhe  
7 nuk do të mbaj të fshehtë asgjë për të cilën kam dijeni.

8 DËSHMITARI: MUSLI HALIMI

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
10 Faleminderit z. Halimi. Tani jeni nën betim për të thënë të  
11 vërtetën.

12 Mund të fillojmë tani me dëshminë e z. Halimi duke  
13 filluar me pyetjet që do t'ia bëjë Avokati i Mbrojtjes.

14 Z. Avokat i Mbrojtjes, keni vlerësuar se ju nevojiten dy  
15 orë për pyetjet që do ja bëni këtij dëshmitari. Ju lutem,  
16 informojeni Trupin Gjykes në momentin që do të kuptoni se ju  
17 duhet më pak apo më shumë.

18 Keni fjalën.

19 Z. VON BONE: [Përkthim] Faleminderit shumë, e nderuar  
20 Gjykatëse.

21 Pyetje nga z. Von Bone:

22 Py. Mirëmëngjes z. Halimi.

23 Pë. Mirëmëngjes.

24 Py. Z. Dëshmitar, për arsye praktike është mirë që të  
25 afroheni më pranë mikrofonit, që të dëgjojnë të gjithë sa më

1 qartë, përgjigjet tuaja.

2 Py. Z. Halimi, i keni dhënë deklaratë Avokatit të Mbrojtjes  
3 më datë 17 gusht 2021; ju kujtohet?

4 Pë. Po.

5 Py. A ju është dhënë mundësia që ta rilexoni këtë deklaratë?

6 Pë. Po.

7 Py. Me aq sa dini, a keni thënë me vërtetësi gjithçka që  
8 është përfshirë në atë deklaratë?

9 Pë. Unë jam përpjekë me thënë të vërtetën.

10 Py. Z. Dëshmitar, unë do të marr një për një disa tema, të  
11 cilat dëshiroj t'i diskutojmë bashkë sot.

12 Z. Dëshmitar, a ju kujtohet se kur në vitin 1999, në mars  
13 të vitit 1999 filluan bombardimet e NATO-s?

14 Pë. Po.

15 Py. Nëse ju kujtohet data, ju lutem na e thoni edhe datën.

16 Pë. Me 24 mars 1999.

17 Py. Aso kohe, ku ishit, ju kujtohet?

18 Pë. Kam qenë në Zllash, në qendrën stërvitore, në shkollë.

19 Py. Do t'i kthehem kësaj pas pak. Po më përpara kam disa  
20 pyetje të para fillestare.

21 A ju kujtohet se kur keni mbërritur në Zllash, kur keni  
22 shkuar në Zllash?

23 Pë. Po.

24 Py. Kur ka qenë?

25 Pë. 15 janar 1999.

1 Py. Nga shkuat në Zllash pra, ku ishit në Zllash përpara se  
2 të shkonit në Zllash?

3 Pë. Unë kam qenë nga viti 1993-1998 në Gjermani. Prej  
4 Gjermanie kam ardh në Shqipëri. Në 1998. Prej Shqipërie kam  
5 ardhur në këmbë deri në Zllash.

6 Py. Në kohën kur keni shkuar në Zllash, u kyçët në UÇK apo  
7 ishit kyçur më përpara. Kur jeni kyçur në UÇK?

8 Pë. Me 5 maj 1998, jam kyç në UÇK.

9 Py. Pasi u kyçët në UÇK, pak a shumë me përfaqësi, a mund të  
10 na thoni se çfarë bënit aso kohe, sepse me sa kuptova, ju në  
11 vitin 1998, nuk ishit ende në Kosovë apo në Zllash. A mund të  
12 na tregoni se çfarë bënit gjatë vitit 1998?

13 Pë. Në Shqipëri kam bërë disa stërvitje, parapërgatitje për  
14 me ardh në luftë.

15 Py. Pas mbërritjes në Zllash ose ta them ndryshe, cila ishte  
16 arsyeja përse shkuat pikërisht aty?

17 Pë. Aty është parapa që do të hapet një qendër stërvitore  
18 edhe unë jam njoft me komandantin e brigadës, ish-komandantin  
19 e brigadës, Adem Shehu, në Tiranë dhe ai ka qenë qëllimi që  
20 unë shkoj në Zllash.

21 Py. Në këtë qendrën stërvitore në Zllash, çfarë bënit?

22 Pë. Pesëmbëdhjetë ditë ka qenë parapërgatitje për hapjen e  
23 qendrës stërvitore, 15 janar deri me 1 shkurt.

24 Py. Ku ndodhej qendra stërvitore, në çfarë lloj objekti  
25 ndodhet?



1 Pë. Qendra stërvitore ka ndodh në fshatin Zllash. Aty ka qenë  
2 një shkollë fillore nga klasa e parë deri në klasën e katërt.  
3 Aty ka qenë -- ajo është shfrytëzu për qendër stërvitore.

4 Z. VON BONE: [Përkthim] Në këtë moment dëshiroj që t'i  
5 kërkoj NJAGJ-së që të shfaqë dy fotografi me numër DSM00549.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.  
7 Sekretare mund të vijoni.

8 Z. VON BONE: [Përkthim] Dhe përbri saj me numër  
9 SPOE00128412.

10 Mbase mund të zmadhojmë fotografinë në të majtë.

11 Py. Z. Halimi, edhe pse është bardh e zi a e njihni këtë  
12 ndërtesë?

13 Pë. Unë po mendoj që është kjo shkolla e Zllashit.

14 Z. VON BONE: [Përkthim] Ju lutem të kalojmë tani te  
15 fotografia tjetër, të zmadhojmë fotografinë tjetër.

16 Py. Po kjo ndërtesë çfarë është z. Dëshmitar?

17 Pë. Edhe kjo po mendoj që e njëjta është. Kjo më e  
18 shkatërrume. Edhe kjo po mendoj që është shkolla e Zllashit.

19 Py. Faleminderit shumë.

20 Z. VON BONE: [Përkthim] Mund t'i mbajmë fotografitë në  
21 ekran për një moment.

22 Py. Në këtë ndërtesë ndodhej qendra stërvitore kur po e  
23 shpjegonit?

24 Pë. Po.

25 Py. A mund të na thoni se si ishte e përbërë kjo ndërtesë,

1 domethënë sa hapësira kishte brenda, sa dhoma i kishte  
2 gjithsej? Nëse ju kujtohej.

3 Pë. Kjo i ka pas katër klasë, një dhomë, një zyrë e vogël ku  
4 unë kam qëndru aty edhe afër saj një objekt ku është  
5 përgatitur ushqimi për ushtarë, kuzhina.

6 Py. Po. Nëse shohim fotografinë në të djathtë.

7 Z. VON BONE: [Përkthim] Ju lutem të zmadhojmë fotografinë  
8 në të djathtë pranë kësaj.

9 Py. Nëse unë do të qëndroja me shpinë nga muri, nga ky muri  
10 ballor që shohim këtu në fotografi dhe pastaj do të shikoja  
11 vetëm përpara, çfarë do të shihja?

12 Pë. Objekt i shkatërrum.

13 Py. Dakord, jo unë këtë e kuptoj. E shikoj objektin e  
14 shkatërrum, por mbase nuk e bëja pyetjen siç duhej.

15 Ajo që përpiqem të them apo të pyes është kjo: nëse  
16 njeriu do të qëndronte me shpinë kah kjo ndërtesë, pra nëse do  
17 të qëndroja ngjit me atë murin që shohim aty, po me shpinë nga  
18 muri, do të thotë që fytyrën do e kisha këtej, çfarë do  
19 shihja, çfarë do kisha përpara më saktë?

20 Pë. Fushë, objekt, domethënë natyrë, oborr.

21 Py. Po. Në rregull. Ai oborr, ajo fushë do të ishte e sheshtë  
22 apo do të ishte disi ndryshe relievi?

23 Pë. Jo ka qenë një pjesë e rrafshët para se me hy në një  
24 oborr, ku edhe aty kemi bo edhe rreshtimin e ushtarëve. Aty  
25 është bë edhe ngritja e flamurit, para se me hy në objekt. Ka

1 qenë një pjesë para objektit vend që kena mujt me u rreshtu  
2 ose me u -- për me u fut në objekt.

3 Py. Po, do t'i kthehem pas pak kësaj. Desha të flas pak për  
4 këtë fushën, këtë vendin e rrafshët. Kjo ishte teposhtë,  
5 telartë apo ishte e gjitha rrafsh?

6 Pë. Një pjesë ka qenë e rrafshët por nuk ka qenë krejt e  
7 rrafshët ka pas edhe lartësi ose -- po në atë pjesën para  
8 hyrjes së shkollës ku ne e kemi bë edhe rreshtimin e  
9 ushtarëve, në hyrje të objektit ose në dalje të objektit,  
10 ngritjen e flamurit apo zbritjen e flamurit, ka qenë një pjesë  
11 e rrafshët, oborr.

12 Py. Po të shohim këtë fotografi këtu, ku e ka hyrjen kjo  
13 ndërtesë, ku e ka pasur hyrjen domethënë? Ose a duket hyrja në  
14 këtë fotografi?

15 Pë. Jo, nuk është kjo pjesë hyrja, që po duket. Është mbrapa  
16 kësaj hyrja.

17 Py. Pra është në anën tjetër të ndërtesës?

18 Pë. Në anën - po.

19 Py. Kur thoshit që rreshtoheshin i ushtarëve apo bëhej  
20 rreshtimi për flamurin, kjo bëhej në anën tjetër të ndërtesës,  
21 apo jo?

22 Pë. Po.

23 Py. Faleminderit shumë.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

25 Avokat, një ndërprerje e shkurtër për transkriptin. Në faqen

1 8, me sa dukej, referenca për SPOE128386 nuk është  
2 regjistruar. E thashë këtë - mund të kthehemi dhe ta shohim  
3 prapë, por e përmenda këtu që të mos ketë asnjë keqkuptim se  
4 për çfarë e kemi fjalën.

5 Mund të vazhdoni ju lutem.

6 Z. VON BONE: [Përkthim] Për të qenë të qartë po flasim  
7 për këtë fotografi.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk  
9 kam dyshim për këtë.

10 Z. VON BONE: [Përkthim] Mirë në rregull.

11 Py. Thatë, sapo thatë që hyrja e ndërtesës është në anën  
12 tjetër të ndërtesës që shohim.

13 Pë. Po.

14 Py. Në këto hapësirat që shohim këtu, në këtë pjesë të  
15 ndërtesës, çfarë bëhej, çfarë kishte aty? Për shembull ishte  
16 zyra juaj apo ishte diçka tjetër se ju e përmendët edhe një  
17 zyrë?

18 Pë. Po ajo zyrë ku kam qenë unë ka qenë zyrë e mëhershëm për  
19 mësues aty që kanë punuar. Unë e kam shfrytëzue. Kam  
20 shfrytëzue edhe zyrë po edhe kam fjetë aty.

21 Py. Ju kuptoj. Po tani që shohim këtë fotografi, që sigurisht  
22 që është një ndërtesë e shkatërruar, po shohim disa hapësira  
23 në këtë fotografi. Mund të na thoni për çfarë përdoreshin këto  
24 hapësira në kohën kur ndodheshit ju aty, në atë qendër  
25 stërvitore?

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
2 Avokati Mbrojtës, po sikur t'i merrnim me radhë nga a majta në  
3 të djathtë a nga e djathta në të majtë. Si ta preferoni ju.

4 Z. VON BONE: [Përkthim] Patjetër.

5 Py. Z. Dëshmitar nga e majta në të djathtë çfarë shohim këtu,  
6 domethënë çfarë bëhej përse përdroreshin hapësirat?

7 Pë. Dy klasë kanë qenë hapësira për pushim të kadetëve. Aty  
8 edhe kanë bë edhe gjumin se ata s'kanë pasë të drejtë të  
9 shkojnë në familje. 15 ditë ka qenë trajnimi intensiv. Kurse  
10 dy klasë të tjera janë përdorur për mësim, njëra për mësim  
11 njëra për kuzhinë, për ushqim, kur janë ushqy. Sepse kadetët  
12 aty janë ushqyer edhe mëngjesin edhe drekën edhe darkën. Kurse  
13 kuzhinierët e kanë pasë një pjesë mbrapa, para objekti të  
14 vogël që t'ua përgatisin ushqimin ushtarëve.

15 Py. Kur thoni përpara ndërtesës, e keni fjalën për atë anën  
16 ku ndodhet hyrja --

17 Pë. Po.

18 Py. -- e ndërtesës, apo në këtë anë?

19 Pë. Po, para.

20 Py. Faleminderit shumë.

21 Z. VON BONE: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, besoj se me  
22 ndërtesën mbaruam.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

24 Faleminderit.

25 Faleminderit znj. Sekretare.

1 Z. VON BONE: [Përkthim]

2 Py. Z. Dëshmitar, çfarë pozite e mbanit ju në qendrën  
3 stërvitore?

4 Pë. Unë në qendër stërvitore kam qenë komandat i qendrës  
5 stërvitore.

6 Py. Qendra stërvitore bënte pjesë në ndonjë njësi apo ishte  
7 njësi më vete apo i përkiste ndonjë njësie të veçantë? Dhe  
8 nëse po mund të na e tregoni se cilës?

9 Pë. Jo, qendra stërvitore ka qenë vartëse e Brigadës 153.  
10 Edhe unë kam qenë vartës i Brigadës 153.

11 Py. Kur mbërritët, pra kur shkuat në Zllash aso kohe, kë  
12 kishit oficer epror, asokohe?

13 Pë. Fatmir Sopin.

14 Pë. Kishit eprorë të tjerë apo kishit vetëm një epror?

15 Pë. Jo, ka pas edhe të tjerë, patjetër.

16 Py. Kush ishin këta të tjerë, mund të na e thoni

17 Pë. Ka qenë Rrahman Dini, Sejdi Veseli, ka pasë edhe të  
18 tjerë.

19 Py. Çfarë pozite kishte Rrahman Dini, në fakt?

20 Pë. Nuk mundet të dham sqarim çfarë pozite ka qenë, unë e kam  
21 pa që ka qenë vartësi, domethënë udhëheqës në atë grupin e  
22 brigadës, por ma shumë jam përqendu në pozitën edhe  
23 bashkëpunimi jem ka qenë me zëvendëskomandantin e brigadës,  
24 Fatmir Sopin. Pozitat kanë mujt me ndryshu aty. Ka qenë  
25 zëvendëskomandant ose shef i shtabit, i operativës, por këtu

1 kanë funksionu të gjitha. Ka pasë edhe zëvendëskomandant edhe  
2 shef shtabi edhe shef të operativës edhe të logjistikës. Po  
3 s'i kam ditë me emra të gjithë.

4 Py. Në rregull. Dhe sa për të qenë i qartë, kush ishte shefi  
5 i shtabit i Brigadës 153?

6 Pë. Nuk mund me thonë sa, me sa di unë ka qenë ky Rrahman  
7 Dini.

8 Py. Në rregull. A keni pasur ndonjë marrëdhënie të veçantë me  
9 Sejdi Veselin sa i takon punës tuaj që kishte të bënte me  
10 trajnimin e njerëzve në qendrën stërvitore?

11 Pë. Po, marrëdhënie të veçantë jo, por bashkëpunim, po. Edhe  
12 me Fatmir Sopin edhe me Sejdi Veselin edhe me Rrahman Dinin.  
13 Normal që kemi pasë bashkëpunim për përpilimin e planit,  
14 hartimin e planit edhe po --. Bashkëpunim, po, kemi pasë.

15 Py. E kuptoj. Sejdi Veseli, Fatmir Sopi dhe Rrahman Dini ku  
16 qëndronin në brigadë? Domethënë ku e kishin vendin ku  
17 qëndronin ata?

18 Pë. Po, shtabi i brigadës ka qenë dikun 500 metra larg  
19 qendrës stërvitore, ma poshtë se qendra stërvitore në fshat,  
20 në një objekt privat, në një shtëpi private. Aty kanë qëndruar  
21 ata.

22 Py. Në rregull. Gjatë të gjithë kohës kur keni qëndruar ju në  
23 qendrën stërvitore, ata kanë qëndruar atje në atë vend, 500  
24 metra larg qendrës stërvitore?

25 Pë. Po.

1 Py. Ky ishte shtabi, ky vendi tjetër që thatë që ishte 500  
2 metra më andej ishte shtabi i brigadës?

3 Pë. Po.

4 Py. Në rregull. Kur folët për Fatmir Sopin, a mund të na  
5 thoni në qoftë se ai flinte në qendrën stërvitore, ku  
6 qëndronit ju, ju flinit dhe ju?

7 Pë. Në qendër stërvitore nuk ka flejtë. Ku ka flejtë ai unë  
8 nuk e di. Sepse ai ka qenë i Zllashit, në vend të vet.

9 Py. Kur thua "në vendin e vet" e ke fjalën për shtëpinë e  
10 tij?

11 Pë. Po nuk e di, ai është i Zllashit.

12 Pë. Në rregull, e qartë. Ju ishit përgjegjës për qendrën  
13 stërvitore. A mund ta quaj kështu, mund ta them në këtë  
14 mënyrë?

15 Pë. Po.

16 Py. Njerëzit ty të drejtoheshin si komandant?

17 Pë. Po.

18 Py. Të thonin "komandant", nuk e di të thonin ndonjë emër  
19 tjetër dhe pastaj të thonin "komandant"? Si të drejtoheshin?

20 Pë. Unë e kam pasur pseudonimin Llapi.

21 Py. Rekrutët e rinj, si ju thërrisnin, si ju drejtoheshin?

22 Pë. Disa Llap, disa komandant. Po emrin tem s'e kanë ditë.

23 Py. Në rregull. E kuptoj. Z. Dëshmitar, si i merrnit ju  
24 rekrutët, nga vinin rekrutët?

25 Pë. Po të gjithë rekrutët që kanë ardh në qendër stërvitore



1 kanë qenë të asaj treve, asaj zone, të Gollakut. Edhe çdo  
2 lagje apo çdo fshat ka pasur nga një aktivist apo përgjegjës i  
3 fshatit. Ai ka mbledhur njerëzit, i ka përzgjedhur dhe i ka çu  
4 listën në Brigadën 153. Brigada 153 e ka vlerësue, e ka  
5 përpiluar atë listë, e ka prurë të gatshme në qendër stërvitore.  
6 Për mu ka qenë, unë vetëm me e zbatu. Jo me e vlerësu apo me e  
7 verifiku. Kjo ka qenë.

8 Py. E kuptoj. Pra, ju merrnit një listë të njerëzve, të  
9 personave të cilët mbërrinin në qendrën stërvitore. Kështu  
10 ndodhte?

11 Pë. Po.

12 Py. Të kthehemi një hap pas përsëri. Pra, ju thatë që  
13 përpilohej apo përgatitej një listë. Ju e merrnit këtë listë  
14 nga brigada. Brigada bënte ndonjë lloj vlerësimi të këtyre  
15 personave?

16 Pë. Unë nuk e di, po sigurisht është bërë një vlerësim i saj.

17 Py. Në rregull. A e dinit ju se çfarë përmbante një vlerësim  
18 i tillë?

19 Pë. Ta thashë ma herët. Unë jam marrë vetëm me zbatimin e  
20 asaj liste.

21 Py. Në rregull. A ishit në dijeni për shembull në qoftë se  
22 njerëzit, personat, rekrutët bënin ndonjë lloj kontrolli  
23 mjekësor përpara se të mbërrinin në qendrën stërvitore, apo  
24 jo?

25 Pë. Në kushte normale është dashtë të bëhet një kontrollim

1 mjekësor, por unë nuk e di. Ka pasë mjekë brigada, po a u ba

2 as'u ba, nuk e di,

3 Py. Në rregull. Sa më përpara e merrnit ju një listë me

4 personat e rinj, me rekrutët e rinj që do të vinin të

5 stërviteshin aty? Sa paraprakisht e merrnit një listë të tillë

6 përpara sesa të fillohej stërvitja konkrete në qendrën

7 stërvitore me këtë grup?

8 Pë. S'maj mend - me sa unë - ka qenë dy-tri ditë para. Para

9 se me fillu gjenerata tjetër. Se gjithë herë jena marrë me një

10 gjeneratë, kurse u parapregatit gjenerata tjetër. Ishin në

11 fund të gjeneratës, ka ardhë lista për gjeneratën e re.

12 Py. E kuptoj. Çfarë lloj informacioni merrnit ju konkretisht.

13 Çfarë informacioni kishte kjo listë, çfarë ju tregonte, çfarë

14 ju thoshte, le të themi, kjo listë lidhur me personat e

15 gjeneratës së re?

16 Pë. Po aty është përshkru gjenerata e cila ka qenë me radhë,

17 për shembull, një, dy, tre ose katër, sa ka qenë, edhe emri,

18 mbiemri, viti i lindjes, vendi prej nga ardh.

19 Py. Lista a jepte ndonjë informacion shtesë lidhur me

20 njerëzit apo persona konkretë apo kapacitete konkrete? Kishte

21 ndonjë gjë tjetër?

22 Pë. Jo. Përpos emrin, mbiemrin, fshatin, jo, diçka më shumë

23 jo. Normal edhe emri, emri i babait, mbiemri.

24 Py. E kuptoj. Gjatë kohës që i keni marrë këto lista, a ju

25 kujtohet në qoftë se kishte njerëz që vinin nga Prishtina dhe

1 që reflektoheshin në atë listë?

2 Pë. Me të thënë të drejtën, jo. Nuk i kam njoft sepse për mua  
3 ka qenë ajo zonë e panjofshme. Nuk i kam njoft.

4 Py. A ke jetuar ndonjëherë në Prishtinë vetë përpara vitit  
5 1998?

6 Pë. Urdhno? Edhe një herë? Edhe një herë me e përsërit, a  
7 bën?

8 Py. Ndjesë. A keni jetuar ju vetë përpara vitit 1998 në  
9 Prishtinë?

10 Pë. Jo.

11 Py. Z. Dëshmitar, kur vinte një gjeneratë e re në qendrën  
12 stërvitore, në atë shkollë, në atë godinë të shkollës,  
13 ndonjëherë e quaj qendra stërvitore, ndonjëherë e quaj  
14 shkollë, por kini parasysh që bëhet fjalë për të njëjtin  
15 objekt. Domethënë e kam fjalën për të njëjtën ndërtesë. Kështu  
16 që ju lutem kijeni parasysh këtë kur të përgjigjeni.

17 Pra kur vinte një gjeneratë e re në shkollë për t'u  
18 trajnuar, cilat ishin gjërat e para që bëheshin?

19 Pë. Gjenerata kur ka ardh në qendër stërvitore ka qenë e  
20 obligume të rreshtohet para objektit, para shkollës. Dhe ne e  
21 kemi marrë listën, i kemi ftu secilin me emër dhe mbiemër dhe  
22 i kena tregu disa rregulla ç'ka lypen për qendër stërvitore  
23 dhe aty i kena pyet nëse dikush nuk pajtohet apo ka probleme  
24 shëndetësore apo nuk mund t'ja del të futet në qendër  
25 stërvitore del një hap para dhe ta lirojmë. Por nuk ka pasë të

1 tillë. Momentin që është pranë ajo, ata janë fut në sallë në  
2 shkollë dhe ne jena marrë me aktivitete sipas planit. Kjo ka  
3 qenë.

4 Py. Në rregull. Juve na përmendët më përpara për ngritjen e  
5 flamurit. Nuk jam shumë i sigurt për referencën, e nderuar  
6 Gjykatëse, por diskutoi këtë gjë kur po diskutonim për  
7 objektin e shkollës.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E  
9 mbaj nga deklarata e mëparshme, por nuk mbaj mend ta këtë  
10 përmendur tani.

11 Z. VON BONE: [Përkthim] A bëhej ndonjë gjë konkrete që  
12 bëhej çdo mëngjes, ndonjë gjë specifike?

13 Pë. Ka qenë obligative çdo mëngjes që të ngrihej flamuri, në  
14 mbrëmje të zbritej flamuri. Flamuri kombëtar.

15 Py. E kuptoj që kjo ishte e detyrueshme që të ngrihej flamuri  
16 dhe të ulej flamuri kombëtar në fund të ditës. Kush ishte i  
17 pranishëm kur bëhej ngritja e flamurit ose kur ulej flamuri?

18 Pë. Ushtarët është dasht të jenë të gjithë.

19 Py. Në rregull.

20 Pë. Kurse ne, kush ka qenë kujdestar, sepse kena kujdestaru  
21 gjatë natës me radhë.

22 Py. Le të trajtoj pak mëngjesin, z. Dëshmitar. Përveç  
23 ngritjes së flamurit në mëngjes, a bëhej ndonjë gjë tjetër  
24 konkrete?

25 Pë. Po.

1 Py. A mund të na thoni se çfarë bëhej?

2 Pë. Në mëngjes është dasht të bëhet zgjimi nga mëngjesi, ka  
3 qenë higjiena personale, 10 minuta, është dashtë të bëhet  
4 fizkultura e mëngjesit, të kthehen në shkollë, t'i rregullojnë  
5 krevatet, higjienën personale, të përgatiten për rresh për  
6 ngritjen e flamurit. Para se me u ngrit flamuri është bërë një  
7 inspektim i çdo ushtari, a është i qethur, i rruar, i  
8 përgatitur. Nëse nuk ka qenë, ka marrë dënim. Është dasht me e  
9 ba atë punë. Nëse ka qenë në rregull, është ngrit flamuri, ne  
10 i kena çu në mëngjes për ushqim nga ora 8 ka fillu mësimi dhe  
11 jena marrë me aktivitete ditore, deri në mbrëmje. Në mbrëmje  
12 ka qenë prapë zbritja e flamurit, pushim, fjetja, këto.

13 Py. E kuptoj. Tani të qëndrojmë pak tek mëngjesi. Të gjithë  
14 personat e pranishëm, a thërriteshin me emër për t'u siguruar  
15 që ishin të pranishëm?

16 Pë. Po.

17 Py. Kjo bëhej çdo ditë kjo ceremoni?

18 Pë. Po. Po.

19 Py. Çfarë ndodhte në qoftë se dikush nuk ishte i pranishëm  
20 aty në këtë pikë të mëngjesit. Domethënë në qoftë se dikush  
21 mungonte, çfarë ndodhte? Çfarë bëhej? Ju kërkoi ndjesë, do ta  
22 bëj edhe një herë pyetjen.

23 Pë. Jo, e kuptova.

24 Py. Nuk ka ndodh mos -- me mungu asnjëri. Nuk ka ndodh  
25 asnjëherë që dikush të mungojë.

1 Py. Sa i madh ishte një grup i një gjenerate të re, për  
2 shembull, afërsisht?

3 Pë. Me sa e mbaj mend, vetëm gjenerata e parë ka qenë dikun  
4 50 veta, kurse gjeneratat e tjera 100 deri 150 veta.

5 Py. Gjenerata e re, gjenerata e parë, kur ka filluar me  
6 stërvitjen?

7 Pë. 1 janar, 1 shkurt, 15 shkurt ka përfunduar. Më fal se gabim  
8 që 1 janar. Po e përsëris edhe një herë. 1 shkurt-15 shkurt.

9 Py. E kuptoj.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

11 Avokat, sa për procesverbal, juve përmendët flamurin. E pamë  
12 dhe e identifikua që është përmendur flamuri në faqen 10, në  
13 rreshtin 13.

14 Z. VON BONE: [Përkthim] Ju kërkohet ndjesë e nderuar  
15 Gjykatëse.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo,  
17 ndjesë për juve.

18 Në rregull, nuk ka problem sa për referencë për  
19 procesverbal.

20 Z. VON BONE: [Përkthim]:

21 Py. A ju kujtohet se kur ka ndodhur që është trajnuar  
22 gjenerata e fundit në atë qendër stërvitore?

23 Pë. Po.

24 Py. Kur është trajnuar?

25 Pë. Gjenerata e fundit ka qenë 1 prill-15 prill.

1 Py. E kuptoj. Ju vetë keni qëndruar në qendrën e trajnimit në  
2 qendrën stërvitore për të gjithë trajnimin e kësaj gjenerate,  
3 domethënë nga data 1 prill deri në 15 prill?

4 Pë. Vetëm në gjeneratën e fundit nuk kam qenë prezent, e  
5 krejt gjeneratën, domethënë e kam lënë në gjysmë.

6 Py. Përafërsisht kur jeni larguar. Kur e keni lënë këtë  
7 gjeneratë, në çfarë date. Kur jeni larguar nga qendra  
8 stërvitore?

9 Pë. Mesa mu më kujtohet, me 7 prill ka fillu lufta në  
10 Prapashticë, Kosovë - ku është edhe kufiri Kosovë-Serbi edhe  
11 unë kam shku atje. Jam përcaktu komandant i batalionit në atë  
12 pjesë nga Brigada 153. Por kam ardhur nga 7 prill deri me 10  
13 prill prapë në mbrëmje në Zllash, në qendrën stërvitore. Kurse  
14 nga data 10, më nuk jam kthyer në qendrën stërvitore dhe kam  
15 qëndruar në luftë në Prapashticë edhe disa fshatra të tjera.

16 Py. Në rregull. Sa për të qenë i qartë edhe pse me datë 7 ju  
17 shkuat në Prapashticë, në darkë ju u kthyer për të fjetur në  
18 qendrën stërvitore. Ju kërkoh ndjesë. Më lejoni ta formuloj  
19 ndryshme pyetjen.

20 Edhe pse ju u larguat me datë 7 prill 1999, për të shkuar  
21 në Prapashticë, pavarësisht kësaj, a u kthyet për të fjetur  
22 gjatë natës në qendrën stërvitore në Zllash deri me datë 10  
23 prill?

24 Pë. Qëllimi im ka qenë që ta përfundoj këtë gjeneratë deri me  
25 15 prill. Edhe forcat serbe në disa vende shumë herë kanë

1 hyrë, përnjëherë brenda dite dhe janë tërheq brenda dite. Unë  
2 duke menduar që do të vazhdojnë ashtu skenari i tyre, nuk e  
3 kam lëshu qendrën stërvitore, kam mendu që ta përfundoj  
4 gjeneratën deri në fund dhe të kthehem në Prapashticë. Por kjo  
5 nuk ndodhi, serbët u pozicionuan edhe unë u urdhërova nga  
6 brigada që ta le qendrën stërvitore të shkoj në batalionin e  
7 Prapashticës. Kjo ka qenë.

8 Pë. Kjo ka ndodhur siç e thatë me datë 10 prill, domethënë me  
9 datë 10 prill u larguat përgjithmonë nga qendra stërvitore.

10 Pë. Po. Dhe nuk jam kthyer më në Zllash.

11 Py. Shumë faleminderit e kuptoj këtë.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

13 Avokat, për mua nuk është akoma e qartë, ju lutem a mund t'i  
14 hiqni dëgjueset?

15 Për mua nuk është ende e qartë në qoftë se nga data 7  
16 deri me datë 10 kur shkoi në -- domethënë, e kuptoj që shkoi  
17 në Prapashticë, nuk është e qartë për mua në qoftë se ka  
18 fjetur në Prapashticë apo është kthyer në qendër stërvitore  
19 dhe ka fjetur atje. Nuk mendoj se iu përgjigj kësaj pyetje.

20 Z. VON BONE: [Përkthim] Në rregull. Mua mu duk se e  
21 sqaroi megjithatë do e sqarojmë përsëri.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë.  
23 Shumë faleminderit.

24 Znj. Sekretare, a mund ta ndihmoni?

25 Në rregull. Shumë mirë z. Dëshmitar që i vutë dëgjueset.



1 Ju lutem vazhdoni z. Avokat.

2 Z. VON BONE: [Përkthim]:

3 Py. Z. Dëshmitar, dua që të jem i qartë për ca çështje. E  
4 kuptoj që me datën 7 shkuan në Prapashticë.

5 Pë. Po.

6 Py. A u kthyet atë mbrëmje në Zllash për të fjetur aty ose a  
7 u kthyer pasdite, pavarësisht domethënë se kur jeni kthyer, po  
8 a jeni kthyer në Zllash?

9 Pë. S'e di se sa u kuptua më herët. Nuk ka qenë qëllimi për  
10 me ardh me fjetë në Zllash. U mundova me e sqaru më herët.

11 Forcat serbe në disa vende kanë hyrë brenda dite dhe janë dalë  
12 brenda dite. Nuk kanë qëndru aty, nuk janë pozicionu.

13 Py. E kuptoj. Më lejo të të ndërpres. Unë nuk jam i  
14 interesuar të di se ku ishin serbët. Jam i interesuar të di se  
15 ku ishe si. Dhe prandaj po të bëj pyetjen. A u kthyet me datë  
16 7 prill sërish për të qëndruar gjatë natës në qendrën  
17 stërvitore në Zllash apo jo? Kjo është pyetja?

18 Pë. Po.

19 Py. Në rregull. Me datë 8 a shkuan përsëri në Prapashticë?

20 Pë. Po.

21 Py. A u kthyer prapë nga Prapashtica në datën 8 për të  
22 qëndruar gjatë natës në Zllash?

23 Pë. Po.

24 Py. Po me datë 9 e njëjta gjë ndodhi?

25 Pë. Po.

Dëshmitari: Musli Halimi (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Von Bone

Faqe 26

1 Py. Po me datë 10 ju shkuat atë ditë në Prapashticë dhe në  
2 qoftë se e kuptova drejt nuk u kthyet më në Zllash.

3 Pë. Po.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

5 Mendoj që nuk punon mikrofoni se nuk po dëgjojmë.

6 Z. VON BONE: [Përkthim] Shpresoj që të jetë reflektuar në  
7 transkript.

8 [Anëtarët e Trupit Gjykes këshillohen]

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

10 Avokat, nga faqja 24, rreshti 8, ju lutem a mund ta përsërisni  
11 pyetje që ka të bëjë me datën 10 dhe pastaj vazhdojmë prej  
12 aty.

13 Z. VON BONE: [Përkthim]

14 Py. Z. Dëshmitar, do ta përsëris sërish pyetjen e fundit që  
15 ju bëra. Pra me datë 10 shkuat prapë në Prapashticë dhe në  
16 qoftë se e kuptova drejtë, atë ditë ju nuk u kthyet më në  
17 Zllash, në qendrën stërvitore në shkollë, është e saktë kjo?

18 Pë. Po.

19 Py. Shumë faleminderit.

20 Z. VON BONE: [Përkthim] Mendoj që e kemi sqaruar apo jo,  
21 e nderuar Gjykatëse?

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

23 Faleminderit z. Avokat.

24 Z. VON BONE: [Përkthim]

25 Py. Z. Dëshmitar, dua të flas pak për ju dhe trajnerët, ju

1 ishit i vetmi trajner që kishte qendra stërvitore?

2 Pë. Jo ka pasë edhe të tjerë.

3 Py. Në rregull. A mund të na thoni emrin e disa trajnerëve të  
4 tjerë që ishin në qendrën stërvitore?

5 Pë. Po. Ka qenë një koleg i imi Bexhet Vitia. Një koleg i imi  
6 Triumfi, Mësuesi, e të tjerë.

7 Py. Atëherë këta tre persona që përmendët, ata ishin që në  
8 fillim që prej fillimit aty në qendrën stërvitore deri le të  
9 themi me datën 10 prill?

10 Pë. Jo, ata kanë qëndruar deri me datën 15 prill.

11 Py. Ju kërkoj ndjesë. Ju ishit trajner vetë në qendrën  
12 stërvitore, si ata, apo jo?

13 Pë. Po.

14 Py. Çfarë trajnonit, çfarë pjese pune, për çfarë ishit ju  
15 përgjegjës në qendrën stërvitore.

16 Pë. Unë jam marrë me trajnim, me përgatitjen fizike se kam  
17 edhe të përfundim fakultetin e edukatës fizike. Po edhe marrë  
18 edhe me disa trajnime taktiko-ushtarake.

19 Kurse kolegët e mi Mësuesi dhe Triumfi, janë marrë me  
20 mësimin e armatimit.

21 Py. E kuptojmë. Kur thua që ju jeni marrë me përgatitjen  
22 fizike, a kishte ndonjë vend konkret ku bëhej trajnimi apo  
23 përgatitja fizike? Pra kishte ndonjë vend ku bëhej trajnimi  
24 fizik?

25 Pë. Po e kemi pasur një vend, ta quaj si fushë e sportit, por

1 jo në atë stilin fushë e sportit. Dikun tre-katërqind metra  
2 larg shkollës dhe shumicën e ushtrimeve fizike i kemi bërë në  
3 atë vend.

4 Py. Çfarë lloj ushtrimesh fizike zhvilloheshin? A mund të na  
5 thuash se çfarë përmbante një trajnim fizik ose një përgatitje  
6 fizike normale?

7 Pë. Të gjitha këto përgatitje fizike kanë qenë përgatitje  
8 kondicionalë, vetëmbrojtje, këto.

9 Py. A mund të na jepni disa shembuj ju lutem?

10 Pë. Si për shembull ka qenë bartja e shoku-shokut, kolegu-  
11 kolegun në rast -- me improvizu në rast se plagoset si mund ta  
12 bartë. Apo kalimi i disa pengesave apo asgjësimi i rojës.  
13 Rreshtimi sidomos ka qenë prioritet rreshtimi, kolona. Kolona  
14 me dy, kjo. Këto ushtrime ka pas. Të gjitha kanë qenë me  
15 qëllim të përgatitjes kondicionale. Që secili të ketë  
16 përgatitje fizike.

17 Py. Në rregull. A kishe atribut që mund ta përdorje atje në  
18 fushë ndërkohë që përgatitje fizikisht personat? A kishte  
19 attribute që ti mund t'i përdorje për këto përgatitje fizike  
20 ose ushtrime fizike?

21 Pë. Jo. Jo.

22 Py. Për shembull a kishte ndonjë vend tela me gjemba ku ata  
23 duhej t'i kalonin telat me gjemba apo të kalonin duke u  
24 tërhequr zvarrë ose për shembull a kishte litarë nëpër pemë ku  
25 do të duhej që të ngjiteshin ata?

1 Pë. Jo.

2 Py. A kishte për shembull, trugje të mëdhenj pemësh ku  
3 personat duhej që t'i kalonin, t'i kapërcenin ose që të  
4 vraponin rreth e qark?

5 Pë. Po.

6 Py. Ku ishin këto?

7 Pë. Krejt kjo hapësirë ka qenë në fshatin Zllash, pjesë-  
8 pjesë, afër poligonit. Ma larg poligonit, aty ka qenë.

9 Py. Sa njerëz merrnin pjesë në këto ushtrime stërvitore?

10 Pë. Ta thashë që gjeneratat kanë qenë 100 deri 150 veta. Një  
11 gjeneratë. E vetmja gjeneratë, e para ka qenë 50 veta.

12 Py. Këto ushtrime fizike i bënit, e udhëhiqnit ju apo kishte  
13 edhe instruktorë të tjerë që ju ndihmonin?

14 Pë. Jo, me përgatitjen fizike jam marrë vetëm unë. Por kam  
15 përzgjedh disa ushtarë që kanë qenë më të shkathtë më të  
16 zhdërvjelltë edhe më kanë përkrahë. Sepse ka qenë numër i madh  
17 dhe ka qenë problematik me i kontrollu secilin se si po e bën.

18 Py. Faleminderit shumë. Përmendët Triumfin, a mund të na  
19 shpjegoni se me se merrej ai, çfarë bënte, kur bënte stërvitje  
20 aty. Ç'lloj stërvitje drejtonte ai?

21 Pë. Ai ka qenë oficer për trajnim me armë.

22 Z. VON BONE: [Përkthim] Nëse ma thoni edhe një herë  
23 sepse, nuk e di nëse mund të më --

24 Py. Emrin e instruktorëve të tjerë, çfarë bënin instruktorët  
25 e tjerë?

1 Z. SHALA: Mësuesi.

2 DËSHMITARI: Mësuesi është marrë me logjistikë. Ai është  
3 marrë me këtë listën që thashë ma herët të kadetëve, prej  
4 brigade deri në qendër stërvitore. Kur e them me logjistikë ai  
5 është dashtë të merret me ushqim të kadetëve, me veshmbathje  
6 nëse ka pasur, domethënë gjithçka ç'ka përfshihet me  
7 logjistikë dhe me personel është marrë Mësuesi. Kurse Bexhet  
8 Vitia dhe Triumfi janë marrë me trajnim, kanë qenë instruktorë  
9 të trajnimit për armë. Ata është dashtë ta mësojnë teorikisht,  
10 ta zbërthejnë praktikisht edhe në fund është dashtë të  
11 testohen me gjuajtje.

12 Z. VON BONE: [Përkthim]

13 Py. T'i kthehem diçkaje që e thatë më herët sot. Folët për  
14 Adem Shehun. Na thoni kush ishte ai?

15 Pë. Adem Shehu ka qenë një oficer i ushtrisë shqiptare të  
16 Shqipërisë. Unë --

17 Py. Në Zllash ka ardhur ndonjë herë?

18 Pë. Ka ardh, veç. Po ka ardh, ka ardh.

19 Py. Po ka ardh me bërë çfarë?

20 Pë. Adem Shehu ka ardhur vullnetarisht në luftë në Zllash.

21 Py. Ju kuptoj. E çfarë pozite ka pasur?

22 Pë. Ai ka qenë komandanti i Brigadës 153.

23 Py. A ju kujtohet kur u bë komandant i Brigadës 153?

24 Pë. Jo nuk më kujtohet. Jo, data s'më kujtohet. E di që me

25 ardhjen e tij në Zllash ai është emëruar komandanti i Brigadës

1 153. Po saktësisht kur ka ardh dhe kur është emëruar, nuk e  
2 di.

3 Py. Ku qëndronte Adem Shehu kur erdhi në Zllash?

4 Pë. Nuk e di, po sigurisht në brigadë, në komandën e  
5 brigadës, ku kanë qëndruar ata të tjerët. Saktësisht nuk e di.

6 Py. Ju kuptoj. Pra, nuk ka qëndruar asnjëherë në shkollë, ku  
7 qëndroje ti?

8 Pë. Jo.

9 Py. A kishte ndonjë detyrë sa i takon stërvitjes, pra qendrës  
10 stërvitore?

11 Pë. Po ai edhe pse ka ardh me vonesë, pothuajse në përfundim  
12 të trajnimit të qendrës stërvitore, ai ka qenë edhe  
13 përpiluesi, hartuesi i planit. Sepse sigurisht ata janë -  
14 domethënë edhe më në fund ka qenë edhe mbikëqyrësi i qendrës  
15 stërvitore pas largimit tim që kam shku në Zllash. Po jo në  
16 atë aspektin me u marrë shumë me ushtarë por ka mbikëqyr. Se  
17 ai ka qenë edhe komandanti i brigadës e ka pasur të drejtë ta  
18 kontrollojë gjithçka.

19 Py. Ju kuptoj. Por gjatë kohës që ju ishit aty, derisa sa ju  
20 ishit aty, të themi të paktën deri më 7 apo 10 prill, ai nuk  
21 ishte njëri prej instruktorëve, të themi, të rekrutëve?

22 Pë. Jo.

23 Py. Po zyrë a kishte ai në qendrën stërvitore.

24 Pë. Adem Shehu?

25 Py. Po, po.

1 Pë. Jo.

2 Py. Po Fatmir Sopi a kishte zyrë në qendrën stërvitore?

3 Pë. Asnjë prej Brigadës 153 s'e ka pasë zyrën në qendrën  
4 stërvitore përpos meje.

5 Py. Faleminderit.

6 Pë. Po ndonjë femër a ka pasur mes rekrutëve?

7 Pë. Jo. Jo.

8 Py. Edhe një pyetje. Triumfi a flinte në të njëjtën ndërtesë  
9 të shkollës ku flinit edhe ju?

10 Pë. Jo.

11 Py. Ndonjërit prej rekrutëve të rinj, a u caktohej, u  
12 ngarkohej ndonjë detyrë gjatë periudhës që bënë stërvitjen?

13 Pë. Detyrat, po, kanë pasë shtesë detyra. Për shembull  
14 rekrutët është dashtë të kujdestarojnë natën, nga dy orë, të  
15 bëjnë roje të objektit, nga dy orë. E kështu me radhë. Kanë  
16 pasë detyra edhe të tjera.

17 Py. Pra, ato bënë edhe roje vetëm natën?

18 Pë. Po.

19 Py. Faleminderit. Dua të flas për disa prej gjeneratave. Në  
20 veçanti gjeneratat që fillojnë më 15 mars deri në fund të  
21 marsit. Pra ishte 15 mars deri më 30 mars, mirë e kam kuptuar?

22 Pë. Po.

23 Pë. A ishte e mundshme që ndonjë prej rekrutëve të kyçej  
24 gjatë kësaj periudhe pasi e kishte filluar stërvitjen kjo  
25 gjeneratë. Domethënë derisa bëhej stërvitja e kësaj gjenerate



1 të vinin edhe të tjerë? Nuk e di a e kuptuat pyetjen?

2 Pë. Po, po të kuptoj pyetjen. Po nuk ka pasë kurrfarë shanse  
3 që të futej dikush jashtë liste. Sepse ka qenë rregull që  
4 lista të merret prej aktivistëve të fshatrave. Të bihet në  
5 brigadë, brigada ta analizojë, ta shqyrtojë, të vjen lista e  
6 kompletimit edhe ne është dashtë ta zbatojmë vetëm atë listë.  
7 Po edhe s'kena pasë kërkesa të tilla që në mes të gjeneratës  
8 të futen në trajnim. Nuk kena pasë.

9 Py. Nëse vinte dikush në shkollë dhe thoshte "dua të hy në  
10 UÇK, dua të hy në stërvitje", a ishte e mundshme kjo gjë a  
11 mund të bëhej?

12 Pë. Jo. S'ka qenë e mundshme. Ai që ka dashtë në kyçet në  
13 Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës ka qenë adresa në komandë në  
14 komandën e brigadës, jo në qendrën stërvitore.

15 Py. Ju kuptoj, por domethënë nuk ishte e mundshme që dikush,  
16 një rekrut të kyçej në stërvitje, ndërkohë që stërvitja kishte  
17 filluar, pra ishte përgjysmë, duhej të priste derisa të  
18 fillonte gjenerata tjetër, kështu?

19 Pë. Jo, po e them me shumë përgjegjësi se s'ka qenë e  
20 mundshme. Edhe s'është dashtë të jetë e mundshme.

21 Py. Në rregull. Ndonjë prej rekrutëve, pra nëse ndonjë prej  
22 rekrutëve bënin detyrën e rojës gjatë natës, na thoni në fund,  
23 pasi ta kryenin detyrën e rojës, çfarë do të duhej që të  
24 raportonin?

25 Pë. Për çdo 24 orë është zgjedhur komandanti i rojës dhe janë

1 përcaktu cilët roje, cilët ushtarë kanë me qenë roje. Ka qenë  
2 orari i përpiluar, prej orës kaq deri në orën kaq. Edhe  
3 udhëheqësi i rojës ka pasur edhe zëvendësin e vet. Njëri ka  
4 qenë deri në orën 12. Tjetri prej orës 12 deri në mëngjes.  
5 Detyra e tyre ka qenë ata ta zgjojnë ushtarin , t'i zgjojnë  
6 ushtarët prej gjumit e t'i dërgojnë roje, atë pjesën tjetër ta  
7 marrin ta futin në dhomën e fjetjes. Normal që komandanti i  
8 rojës është dashtë t'i raportojë oficerit kujdestar në  
9 mëngjes, t'i raportojë për gjendjen gjatë natës, si ka kaluar.  
10 Kjo ka qenë.

11 Py. Sa njerëz bënin roje gjatë një nate normale?

12 Pë. Po ajo ka qenë e përpilume me orar, ka qenë dy vende roje  
13 edhe janë përcaktu sipas orarit. Ka mund të jenë shtatë-tetë,  
14 dhjetë veta. Se janë ndërruar dhe me rregull ka qenë dy orë,  
15 por për shkak të temperaturave të larta, se ka qenë dimër,  
16 ftohtë, jemi munduar t'ja pakësojmë orarin, t'ja bëjmë nga një  
17 orë.

18 Py. Kur thua "ishte ftohtë, temperatura të ftohta", për cilën  
19 periudhë bëhet fjalë?

20 Pë. Për muajin shkurt. Edhe një pjesë të muajit mars. Po  
21 sidomos në muajin shkurt. Se në fillimin e muajit mars, prapë  
22 ka vazhdue nga dy orë. A vendin ku kena qëndru ne në Zllash ka  
23 qenë një lartësi mbidetare mbi 1200 metra. Atje me të vërtetë  
24 ka qenë një dimër i ftohtë me borë.

25 Py. Nëse rekruti nuk e përballonte dot, nuk e mbante ritmin e

1 stërvitjes, domethënë që ta them ndryshe, dua të them këtë:  
2 nëse gjatë stërvitjes rekruti nuk ishte në gjendje të  
3 përparonte me ritmin e stërvitjes, ç'bëhej me këtë rekrut?  
4 Pë. Nuk na ka ndodh që një rekrut ta lëshojë trajnimin sepse  
5 ata të gjithë kanë ardh me një vullnet të mirë dhe qëllimi i  
6 tyre ka qenë që të bëhen ushtarë dhe të kontribuojnë në  
7 çlirimin e vendit të vet. Kështu që gjithçka që ata i ka mbaj  
8 i ka mbajtur vullneti, kurajo, guximi. Kështu që nuk kemi pasë  
9 rast që edhe një ushtarë që të thotë "Nuk mund ta përballoj  
10 këtë trajnim, apo dua të kthehem nga ka ardhur". Nuk kena  
11 pasur.  
12 Py. Gjatë stërvitjes, pra pasi e kishte filluar stërvitjen  
13 rekruti, deri sa bënte stërvitjen rekruti, a e kishte  
14 mundësinë ai që të thoshte "nuk dua të vazhdoj më, dua të  
15 shkoj në shtëpi". A ishte e mundshme kjo gjë?  
16 Pë. Jo. Ta thashë edhe një herë, gjithsecili ushtar ka ardhur  
17 me një vullnet të mirë edhe ka ardhur me një qëllim që të  
18 bëhet, të parapërgatitet, që të bëhet një ushtar i Ushtrisë  
19 Çlirimtare të Kosovë dhe të kthehet nga ka ardhur që të  
20 kontribuojë në vendin e vet.  
21 Kështu që nuk kena pasur një rast, ndonjë rast që ta  
22 lëshojë apo të thotë "nuk mund ta përballoj", apo të largohet  
23 prej qendrës. Nuk kena pasë rast.  
24 Py. Ju kuptoj. Cekët grupe 100, 200 persona, është grup shumë  
25 i madh.

1 Pyetja ime është kjo: të gjithë këta njerëz strehoheshin,  
2 pra ndodheshin më saktë në atë ndërtesë shkolle?

3 Pë. E kena shfrytëzu edhe një objekt afër shkollës ka qenë  
4 për fjetje. Kurse mësimi, ligjëratat, ushqimi është bërë në  
5 shkollë.

6 Py. Në shkollë nuk kishte vend ku me fjetë rekrutët?

7 Pë. Po kuptohet që nuk ka qenë një akademi moderne që të kenë  
8 hapësirë ushtarët të flenë komod. Normal që është dashtë që të  
9 bëhet pak më problematik, po është dashtë t'ia dalim. Nuk kanë  
10 qenë kushtet 100 për qind të mira, po është dashtë në ato  
11 kushte që kanë qenë, t'ja dalim edhe pse s'ka qenë hapësira e  
12 mjaftueshme, por disi është dashtë që t'ja dalim. Kurse  
13 ushqimin e kena bë me faza, domethënë pjesë-pjesë. Një pjesë e  
14 kena çu në sallë me u ushqy. Tjetra ka pritë. Kur e ka  
15 përfundu ajo ka shku tjetra. Domethënë nuk i kanë zënë klasa  
16 të gjithë. Ose ligjëratat edhe ato i kena bë pjesë-pjesë. Një  
17 grup e kam marrë unë e kam qit në natyrë, një grup tjetër e  
18 kanë marrë oficerë të tjerë kanë punuar në shkollë. Kjo ka  
19 qenë një koordinim mes trajnerëve. Edhe thjesht është dashtë  
20 t'ia dalim.

21 Py. Po, e kuptoj këtë. Jo unë desha të dija faktikisht se ku  
22 flinin njerëzit. E kuptoj, pra, që ishte një ndërtesë tjetër,  
23 diku gjetkë, domethënë, ku flinin. Por brenda në shkollë,  
24 brenda ndërtesës së shkollës ku e kishit ju vetë zyrën dhe  
25 flinit dhe ju vetë, nuk kishte mundësi, nuk është se flinin

1 njerëzit aty?

2 Pë. Në zyrën time?

3 Py. Jo.

4 Pë. A në objekt?

5 Py. Jo, jo, në një klasë tjetër të shkollës?

6 Pë. Po, po. Dikun me 10 për qind ka pasë kapacitet, s'po them  
7 kapacitet modern, po kanë pasë mundësi të flenë në shkollë. Ta  
8 thashë më herët, ka pasë gjenerata 100 deri 150 veta.

9 Saktësisht tash s'po mund ta jap numrin, po kjo ka qenë  
10 kështu. Shumica e gjeneratave ka fjetë në objekt, në shkollë.  
11 Po ka qenë shtesë edhe një objekt tjetër afër shkollë ku edhe  
12 aty është dashtë të bëjmë roje, ta menaxhojmë. Kur s'i ka zënë  
13 shkolla e kena shfrytëzu edhe atë objekt afër shkolle. Ka qenë  
14 dikun 20 metra ma larg shkolle.

15 Py. Kuptova. Përafërsisht, sa njerëz mund të qëndronin në atë  
16 klasë apo në më shumë -- në shkollë, maksimumi? Pra gjatë të  
17 gjithë stërvitjes sa mund të qëndronin aty?

18 Pë. Një klasë kanë muj me kanë 40, 50 veta, deri në 60 veta.

19 Py. Kishte shtretër?

20 Pë. Po.

21 Py. Faleminderit, faleminderit shumë.

22 Po ushqimin kush ja jepte shkollës, domethënë nga vinte  
23 ushqimi?

24 Pë. Ushqimi sigurisht - brigada e ka pasur strukturën e vet.

25 Ka pasur edhe shefin e logjistikës, që logjistika është marrë

1 me ushqim, veshmbathje. Si ka ardhur deri aty, unë nuk e di,  
2 po aty ku unë kam qëndru, ka pasur kuzhinier që kanë punuar në  
3 kuzhinë kanë qenë disa vetë. Edhe ata janë marrë me  
4 përgatitjen e ushqimit. E thashë më herët ka qenë një objekt i  
5 vogël ku ka qenë kuzhina. Kurse ushtarët janë ushqy tri herë  
6 në ditë, mëngjes, drekë edhe darkë.

7 Z. VON BONE: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, unë do të  
8 kaloja tani në një temë tjetër. Por një temë e gjatë. Kështu  
9 që mendoj se tani është momenti normal për të bërë pushimin.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
11 Faleminderit z. Avokat për këtë. A mund ta informoni Trupin  
12 Gjykses se sa kohë do t'ju duhet pas pushimit?

13 Z. VON BONE: [Përkthim] Besoj nja një gjysëm ore. Nuk e  
14 di se sa kohë kam konsumuar deri tani.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Një  
16 orë e një çerek besoj.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Besoj  
18 se do të bëj edhe gjysmë orë pyetje.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
20 Faleminderit.

21 Z. Dëshmitar tani do ta bëjmë një pushim gjysmë ore.  
22 Asistentja e sallës do t'ju shoqërojë të dilni nga salla tani.  
23 Pastaj do të rifillojmë në 10.25 [sipas përkthimit]. Do të  
24 riktheheni këtu pra, në orën 10.25 [sipas përkthimit] për të  
25 vijuar me pyetjet. Faleminderit.

1 DËSHMITARI: Faleminderit.

2 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë  
4 mirë. Bëjmë ndërprerjen tani, rifillojmë në 11.30.

5 --- Pauza fillon në orën 10.58

6 --- Seanca rifillon në orën 11.30

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë  
8 se u kthyet përsëri.

9 Znj. Sekretare, ju lutem a mund ta shoqëroni dëshmitar  
10 brenda sallës së gjyqit.

11 Të shohim se kush janë të pranishëm. Shoh që të gjithë  
12 ata që ishin të pranishëm në mëngjes janë edhe tani të  
13 pranishëm në sallë.

14 Pas marrjes në pyetje të dëshmitarit nga Mbrojtja,  
15 planifikoj që të bëjmë pushimin e drekës, në mënyrë të tillë  
16 që të fillojmë me kundërpjetet dhe me pyetjet e Avokates për  
17 Viktimat pas pushimit të drekës.

18 [Dëshmitar vijon dëshminë]

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë  
20 se u kthyet z. Dëshmitar.

21 DËSHMITARI: Faleminderit.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani  
23 do t'ia jap fjalën Avokatit, në mënyrë të tillë që të mund të  
24 vazhdojë me pyetjet në drejtimin tuaj.

25 Ju lutem, z. Avokat, e keni ju fjalën.

1 Z. VON BONE: [Përkthim] Shumë faleminderit, e nderuar  
2 Gjykatëse.

3 Py. Faleminderit, z. Dëshmitar.

4 Z. Dëshmitar, duam që të kthehemi përsëri tek fillimi i  
5 gjeneratës së re. Kemi disa pyetje në mënyrë që të mund të  
6 sqarojmë çështje të lidhura me këtë.

15 detaje për emrat e njerëzve dhe për data kur për ta është  
16 mbajtur shënim se kanë munguar për shkak të sëmundjes fjala  
17 bie?

18 Pë. Jo. Unë këtë që po e them është e vërtetë që e kam cekë  
19 edhe ma herët, gjithçka që e kam e thanë është e vërtetë. Ju a  
20 besoni a s'besoni nuk e di.

21 Py. Dakord. E kuptoj z. Dëshmitar. Pra, mbajtja e shënimeve,  
22 mbajtja e listave dhe e fletoreve ishin mjete të cilat ju dhe  
23 të tjerët në qendrën stërvitore i kishit për të mbajtur mend  
24 hollësitë dhe veçantitë lidhur me qindra rekrutë të cilët janë  
25 stërvitur aty, apo jo?

1 Pë. Po.

2 Py. Dhe pa këto nuk mund të flisni me saktësi për shënimet që  
3 janë mbajtur aso kohe ato ditë. A mund ta themi dhe kështu?

4 Pë. Po, është e vërtetë.

5 Py. Në rregull. Na folët për numrin e secilës gjeneratë, pra  
6 sa ishin pak a shumë, pra, duke filluar nga gjenerata e dytë  
7 ishin rreth 150.

8 Sa i takon një klase normale sa e madhe ishte?

9 Pë. Dikund 60-70 veta.

10 Py. Pra të gjithë rekrutët, pra, 150 rekrutët nuk është se  
11 trajnoheshin të gjithë së bashku siç ishin; apo jo?

12 Pë. Kur ka pasë të bëjë me klasa me praktikue anën teorike i  
13 kemi nda me grupe. Kurse ka pasë trajnime që dhe janë trajnuar  
14 të gjithë, për shembull, në terren, në poligon, shumicën e  
15 orëve të mia që unë i kam pasë kam punu me të gjithë sepe 70  
16 për qind të orarit të lëndprogramit unë e kam zbatue në  
17 natyrë, jashtë shkolle.

18 Py. Jo e kisha fjalën që 150 rekrutë janë ndarë në disa grupe

19 --

20 Pë. Po.

21 Py. -- për t'u kryer domethënë trajnimi. Po instruktorët i  
22 merrnin me radhë këto grupe?

23 Pë. Po.

24 Py. Thatë se stërvitja që ju bëni ishte përgatitja fizike e  
25 rekrutëve në faqen 25, rreshti 16 ka qenë kjo. Kështu?

1 Pë. Po.

2 Py. Shpjeguat sepse ju vetë jeni diplomuar për edukim fizik.

3 Është në rreshtin 17, e njëjta faqe. Po ju vetë keni ndonjë

4 aftësim tjetër në këto disiplina fizike?

5 Pë. Po.

6 Py. Për shembull?

7 Pë. Kam të bëj edhe me arte marciale.

8 Py. Jeni formuar vetë në arte marciale?

9 Pë. Po.

10 Py. Sa u takon instruktorëve të tjerë na treguat disa prej

11 emrave të tyre. Faqe 25, rreshtat 8 deri në 9. Triumfi,

12 Mësuesi dhe Bexhet Vitia.

13 A mund t'ju pyes tani cili pra, çfarë emri kishte të

14 vërtetë Triumfi?

15 Pë. Po. Emri i Triumfit ka qenë Emin Borovci.

16 Py. Po emri i Mësuesit?

17 Pë. Emrin nuk -- se gjithë herë i kam thirrë Mësues. Po

18 mbiemrin e ka Gashi. Emri s'më kujtohet.

19 Py. Këta instruktorë qëndronin gjatë ditës në qendrën

20 stërvitore gjatë kohës që bëhej stërvitja trajnimi?

21 Pë. Po.

22 Py. Sa i takon z. Adem Shehu na thatë në faqen 29, rreshtat

23 20 deri 21, se ai hartoi planin. Ma merr mendja e kishit

24 fjalën për planin për qendrën stërvitore apo jo?

25 Pë. Po.

1 Py. Çfarë roli tjetër kishte ai në programin stërvitor nëse  
2 kishte ndonjë rol tjetër?

3 Pë. Po Adem Shehu ka qenë komandant i brigadës domethënë edhe  
4 qendrën stërvitore ka qenë nën komandë të brigadës. Kështu që  
5 ka mund ta kontrollojë kurdoherë se ai ka qenë komandantë i  
6 brigadës.

7 Py. Kur thoni "ta kontrollojë" e keni fjalën që vinte në  
8 qendrën stërvitore kurdoherë?

9 Pë. Nuk ka ardhë po ka pasë të drejtë të vijë. Domethënë nuk  
10 kish mund kurrkush ta pengojë.

11 Py. Po ai vetë ka shërbyer si instruktor në ndonjë moment të  
12 caktuar?

13 Pë. Jo.

14 Py. Jeni i sigurtë për këtë?

15 Pë. Mbase që kam shku unë në Prapashticë u marr ma shumë me  
16 qendrën stërvitore, po sa kam qenë unë jo.

17 Py. Në rregull. Dëshiroj që të sqaroj atëherë një pjesë të  
18 deklaratës që ja keni dhënë Avokatit të Mbrojtjes.

19 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk e di  
20 nëse mund ta nxjerrë në ekran është me numër DSM00539 deri në  
21 00550. Nga kjo më duhet faqja 9.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.  
23 Sekretare, ju lutem të veproni kështu.

24 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Ju lutem ta zmadhojmë  
25 paragrafin 4, ku ka pyetje dhe përgjigje. Jo është në rregull

1 kaq.

2 Py. Do të filloj të lexoj nga disa pyetje dhe përgjigje midis  
3 Avokatit Mbrojtës dhe juve dhe kur po flisnit për Adem shehun  
4 dhe pastaj kam një pyetje sqaruese.

5 Pyetja që jua ka bërë Avokati:

6 "Ku rrinte Adem Shehi, ku flinte?

7 "Ai rrinte në shtabin e brigadës".

8 "Ku gjendej ky?"

9 Përgjigja juaj është:

10 "Ishte rreth 300-400 metra larg shkollës. Ishte një  
11 shtëpi private."

12 Pyetja:

13 "E ke vizituar shtabin e komandës së brigadës?"

14 Përgjigja juaj është:

15 "Jo. Ai vinte te ne dhe kishte të drejtë të na  
16 kontrollonte. Gjithashtu merrte pjesë në stërvitje. Ai ishte  
17 trajneri kryesor".

18 Ju kujtohet që e keni dhënë kështu?

19 Pë. Po.

20 Py. Po veç një minutë përpara, kur pyetjes time që jua bëra  
21 nëse ka marrë pjesë ndonjëherë në trajnim stërvitje pra, z.  
22 Shehu, ju u përgjigjët që jo.

23 Pë. Ai e ka pasë të drejtën ta kontrollojë. Ai ka qenë  
24 komandantë brigade. Por, nuk --

25 Py. Po mund të vazhdoni, mund të vazhdoni.

1 Pë. Thashë ai ka qenë komandanti i brigadës edhe e ka pasë të  
2 drejtën kurdo që ai e ka pa të arsyeshme ta kontrollojë  
3 qendrën stërvitore.

4 Py. Po, z. Halimi, po këtu përgjigja jua j s'ka të bëjë më me  
5 kontrollet. Ju keni thënë në veçanti që:

6 "Ai gjithashtu merrte pjesë në stërvitje. Ishte trajneri  
7 kryesor".

8 Po lexoj nga përgjigja jua që ja keni bërë pyetjes së  
9 Avokatit të Mbrojtjes.

10 Pë. Ai i ka qenë përpiluesi i planit kryesor. Domethënë ai  
11 është marrë edhe me përpilimin e planit. Kështu që ka qenë e  
12 panevojshme që ai të merret me stërvitje. Kurse kena qenë ne  
13 si instruktorë. Ai ka mund të vij ndonjëherë me na vizitu po  
14 sa i përket stërvitjeve, jemi marrë ne si instruktorë. Ai ka  
15 qenë e mjaftueshme vetëm me të këshillue apo me të sugjerue.

16 Py. Po, por ai merrte pjesë në stërvitje keni thënë dhe ishte  
17 dhe trajneri apo instruktori kryesor.

18 Pë. Unë jam mundu me spjegju këta ça po i them tash që ai  
19 vetëm një sugjerim me ta dhanë ka qenë e mjaftueshme. Sepse ai  
20 ka qenë oficer i Tiranës dhe ka pasë një avancim ma të lartë  
21 se ne. Domethënë në aspektin ushtarak ka qenë shumë më i  
22 përgatitur se ne.

23 Py. Po e kuptoj. Po a ishte apo jo ai një prej instruktorëve  
24 apo trajnerëve?

25 Pë. Nuk muj me e quajte instruktor atë. Ai ka qenë komandant

1 brigade. S'ka qenë instruktor. Instruktor jo. Po këshillues.

2 Py. Pra, a kishte ai të drejtën që të ishte i pranishëm në  
3 qendrën stërvitore gjatë seancave trajnuese?

4 Pë. Po. Ka mund të ketë të drejtë.

5 Py. Në rregull.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po  
7 jam dakord. Nuk e kemi një përgjigje. Për mua ende nuk është e  
8 qartë, z. Dëshmitar, se çfarë do të thoni se ajo që keni thënë  
9 në deklaratën që e keni dhënë Avokatit Mbrojtës që "ai ka qenë  
10 trajneri kryesor"? Çfarë keni dashur të thoni me këtë  
11 "trajneri kryesor"?

12 Unë e kuptoj, por dua që të na e shpjegoni dhe ju se kur  
13 thua që ishte trajneri kryesor, ky është më trajneri më  
14 kryesor.

15 Po kështu keni shkruar që merrte pjesë në - jo, prisni  
16 pak. Në përgjigjen që i dhatë Prokurores kjo nuk e sqaron këtë  
17 gjë.

18 Pra, ju lutem na e sqaroni se çfarë keni dashur të thoni.  
19 Se nëse e lexoj këtu ashtu ishte një nga trajnuesit kryesor,  
20 pra, jo thjesht një trajnues por dhe më i rëndësishmi,  
21 kryesori.

22 Keni fjalën

23 DËSHMITARI: Në momentin me ardhë unë komandantit të  
24 brigadës Adem Shehu nga Shqipnia, ai është emëru komandantë  
25 brigade edhe vetvetiu mund ta quash që ka qenë edhe trajneri



1 kryesor edhe në qendrën stërvitore sepse edhe unë kam qenë  
2 nxënës i tina. Domethënë shumë mësimë kam marrë nga ai në  
3 Tiranë por me i shprehë në qendrën stërvitore në Zllash.  
4 Kështu që në atë aspekt e kam quajhtë sepse ka qenë komandant  
5 brigade po dhe ka qenë domethënë trajneri kryesor edhe për  
6 qendrën stërvitore. Këtë e kam mundu ta shpjegoj.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
8 Pyetja ishte: A e vizituar shtabin e komandës së brigadës?"

9 Pra, pyetja që është bërë. "A e ke vizituar shtabin e  
10 komandës së brigadës?"

11 Dhe përgjigja juaj ishte: "Jo".

12 "Ai" vinte, domethënë dhe këtu bëhet e kuptoj behet fjalë  
13 për Adem Shehun. "Ai vinte te ne. Dhe kishte të drejtën të na  
14 kontrollonte". Pastaj keni thënë "Gjithashtu merrte pjesë në  
15 stërvitje"

16 Prapë nuk e kuptoj shumë mirë shpjegimin tuaj, nuk e  
17 kuptoj mirë se ju vetë këtu keni thënë vinte ai te ne pra që  
18 nuk shkonit ju tek ai por ai vinte te ju, pra, te personat që  
19 bënë stërvitje dhe merrte dhe pjesë.

20 A mund të më shpjegoni se çfarë keni dashur të thoni këtu  
21 me fjalën "merrte pjesë"

22 DËSHMITARI: Ndoshta qëllimi jem ka qenë që të merrte  
23 pjesë në përpilimin e planit për trajnim. Adem Shehu ka ardhë  
24 ka fundi marsit në Zllash edhe ka qenë një kohë shumë e  
25 shkurtë në kontakt i jemi me ta. Derisa ka fillu lufta në

1 Prapashticë me 7 prill. Ajo ka qenë një javë, dhjetë ditë ma  
2 shumë s'ka qenë. Kështu që i ka mund, mu s'po më kujtohet, po  
3 ka mund të vij e ka pasë të drejtën të vijë.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
5 Mbetem disi e paqartë megjithatë nuk do ngul këmbë nuk do  
6 vazhdojë.

7 Znj. Prokurore, keni fjalën.

8 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar  
9 Gjykatës.

10 Py. Z. Dëshmitar, kur keni thënë këtu se "vinte ai te ne"  
11 pra, e kuptoj qartë që jeni takuar, domethënë, e keni parë z.  
12 Adem Shehu në qendrën stërvitore?

13 Pë. Po.

14 Py. Po kaloj në një temë tjetër atëherë.

15 Na thatë sot - më fal se mbërritët keni shku në Zllash  
16 domethënë, më datë 15 janar.

17 Bëhet fjalë për faqen 7, rreshti 10, të procesverbalit.

18 Mund të na thoni si ju kujtohet data e saktë 15 janar?

19 Pë. Po më kujtohet se më 5 janar kam fillu pej Shqipnie me  
20 ardhë në këmbë deri në Zllash. Kam bë 10 ditë rrugë derisa kam  
21 ardhë në Zllash. Kështu që kjo datë s'e harroj se ka qenë  
22 bukur një rrugë e gjatë e vështirë kohë dimri një peshë të  
23 ngarkuar në krahë. Kështu që nuk e harroj kurrë këtë datë. Kjo  
24 është për mua edhe ka qenë hera e parë që unë kam ardhë në  
25 Kosovë dhe jam rreshtu në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.

- 1 Py. Librin me titull "UÇK-ja, Zona Operative e Llapit të  
2 Skënder Zhitisë që është botuar në vitin 2008 a e njihni apo a  
3 dini për të?  
4 Pë. Jo. Veç e di që me emër e di kush është.  
5 Py. Po thoni që librin nuk e njihni?  
6 Pë. Librin po. Ju po pyetni për librin apo për personin?  
7 Py. Në fillim flasim për librin. Pra, këtë libër a e dini?  
8 Pë. Po, po.  
9 Py. Po z. Zhitia e keni takuar ndonjëherë?  
10 Pë. Po ai ka punu në Trupat Mbrojtëse të Kosovë gjithashtu  
11 kam punu edhe unë.  
12 Py. Z. Zhitia ju ka intervistuar lidhur me faktet në bazë të  
13 të cilave e ka shkruar dhe librin?  
14 Pë. Po.  
15 Py. Pra, njiheshit me të, jeni takuar me të?  
16 Pë. Jemi takuar një herë me të.  
17 Py. Po, se ju përgjigjët edhe pyetjes sime në rreshtin 15:  
18 "Jo, e njoh me emër. E njoh se kush është ky emër."  
19 Pra, në fakt, e njihni dhe jeni takuar me z. Zhitia?  
20 Pë. Po një herë jam taku me të.  
21 Py. Kjo hera, kjo një herë pra, që jeni takuar me të, ishte  
22 të bënte me disa pyetje të cilat ai do jua bënte dhe ju t'i  
23 përgjigjeshit atij për të shpjeguar faktet në bazë të cilave  
24 ai pastaj ka shkruar edhe librin? Ky ka qenë qëllimi i  
25 takimit?

1 Pë. Po.

2 Py. Dëshiroj t'ju kërkoj një koment lidhur me një pjesë të  
3 atij libri që ka të bëjë me Zllashin.

4 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Dhe dua që në ekrane të shfaqet  
5 dokument me numër ERN SPOE00055870 deri në SPOE00055988-ET.

6 Kam edhe referencat për versionin në shqip të librit kështu që  
7 do të kërkoj që të shfaqen edhe ato nëse nuk ka kundërshtim  
8 Trupi Gjykues.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund  
10 të vazhdoni.

11 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Në rregull.

12 Pra, në njërin anë kemi versionin në anglisht. Kërkoj tani që  
13 të shfaqet edhe versioni në shqip që është me numër  
14 SPOE000556018 dhe deri në faqen - dhe faqen 216 në shqip.  
15 Faleminderit.

16 Py. Z. Dëshmitar, unë do të lexoj në anglisht po mund ta  
17 ndiqni është paragrafi 2, aty në shqip mund ta ndiqni dhe  
18 përmes përkthimit me gojë por edhe përmes tekstit që keni  
19 përpara.

20 Pra, po lexojmë nga paragrafi 2:

21 " Aso kohe luftimesh të vazhdueshëm disa prej luftëtarëve  
22 të cilët kishin shkuar në Shqipëri për armë në tetor të vitit  
23 1998, u kthyen më 29 janar pas një udhëtimi të vështirë dhe të  
24 rrezikshëm nga luftimi dhe nga klima e vështirë. Ushtarët të  
25 cilët sollën armë ishin Nazmi Ajeti, Milaim Berisha, Muhamed

1    Aliaja, Shaban Kurtolli, Halim Potera, Musa Salihu dhe Musli  
2    Halimi, me disa luftëtarë nga Zona Operative e Karadakut".  
3            z. Halimi, duket se ju ishit pjesë e këtij grupi  
4    ushtarësh të cilët janë kthyer nga Shqipëria më 22 janar të  
5    vitit 1999. Pra, mos ka qenë mbase data 22 dhe jo data 15 kur  
6    në të vërtetë jeni kthye në Kosovë prej Shqipërisë? Se ka e di  
7    që ka ndodhur para një kohe shumë të gjatë.

8    Pë.    Jo. Data që jeme që e kam thënë është më e saktë. Unë me  
9    këta jam nda në Zonën e Llapit. Ata këta kanë vazhdu prapë  
10   rrugën në fshatin Majac edhe unë kam qenë i detyruar nga  
11   Majaci të vij në Zllash. E unë prej tyne jam nda. Kështu që  
12   kjo datë që e ka thënë Skënder Zhitia me datën time nuk  
13   përputhet. Unë mendoj që data ime është e saktë.

14   Py.    Në rregull. Pra, po thoni që ju kujtohet, e mbani mend që  
15   ishte në datë 15 dhe jo në datë 22?

16   Pë.    Po.

17   Py.    Kur jeni kthi prej Shqipërisë kështu?

18            Z. Zhitia a i keni dhënë dhe detaje të tjera kur keni  
19   diskutuar për ngjarje ju kanë sjellë në Kosovë, flasë gjatë  
20   intervistës me të?

21   Pë.    Z. Zhitia ma shumë ka pyete për aktivitetin tem në  
22   qendrën stërvitore në Zllash. Edhe në batalionin ku unë kam  
23   qenë në luftim -- domethënë, pjesë e atij batalioni.

24            Domethënë, këto kanë qenë ma shumë pyetjet e tina rreth  
25   meje.

1 Py. Në rregull. Ju kuptoj. Kalojmë tani në një faqe tjetër të  
2 këtij libri. Dëshiroj t'ju pyes për këtë. Behet fjalë për  
3 faqen 71 të versionin në anglisht.

4 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Ndërsa në versionin shqip është  
5 faqja 263.

6 Në fakt, kalojmë në faqen 70 të anglishtes, do të filloj  
7 të lexoj nga fundi i kësaj faqeje -- për nga fillimi i fjalisë  
8 për të dhënë kontekstin dhe e njëjta vlen edhe për shqipen,  
9 pra, 262, faqja e mëparshme. Diku nga fundi i faqes.

10 Py. Do filloj të lexoj një pjesë, pra, paragrafi ka të bëjë  
11 me zonën operative të Llapit nga data 7 prill deri më datë 20  
12 prill të vitit 1999.

13 "Në këtë situatë, komandant Shehu vendosi që ta mbyllte  
14 qendrën stërvitore dhe dërgoi Musli Halimin në Prapashticë..."

15 Ju lutem të kalojmë tani në faqen 71.

16 "...dhe Bexhet Vitinë në Marec me qëllim për të krijuar  
17 strukturat komanduese dhe organizative të njësive të asaj  
18 pjese".

19 Dhe pastaj libri flet për luftimet 7 dhe 8 prill në  
20 Prapashticë, për të cilat gjithashtu ju na folët sot më herët.

21 Lidhur me këtë paragraf edhe Vitia ka qenë një prej  
22 instruktorëve, apo jo?

23 Pë. Po.

24 Py. Edhe Vitia u largua nga qendra stërvitore dhe shkoi në  
25 Marec?

1 Pë. Bexhet Vitia nuk u largua definitivisht se ai ka qenë  
2 edhe i atij fshati i -- ku dhe ka qenë qendra stërvitore. Edhe  
3 luftimet nuk kanë fillue në Marec më 7 prill, po në  
4 Prapashticë. Dhe Bexhet Vitia e ka përfundu gjeneratën,  
5 domethënë, ka ndejtë deri në fund. Kurse unë nuk kam pasë  
6 mundësi ta përfundoj deri në fund. E kam lëshue. Kam fillu më  
7 7 prill, kurse më 10 prill definitivisht nuk jam kthi më në  
8 Zllash. Por kam qëndru në Prapashticë deri në përfundim të  
9 luftës.

10 Py. Po. Do të kalojmë tek lëvizjet tuaja. Tani për momentin  
11 thjesht doja të kuptoja në qoftë se ju e dinit se kur është  
12 larguar Vitia nga qendra stërvitore. Ju thatë që ai ka  
13 qëndruar deri në datë 15 prill, e thatë edhe sot këtë gjë në  
14 faqen 25 dhe rreshtin 12. Ju lutem, vetëm një çast.

15 Dua t'ju pyes, në qoftë se ishit në dijeni që gjatë kësaj  
16 periudhe, pra, në fillim të prillit z. Vitia ka lëvizur në  
17 vende të tilla si Mareci, siç keni bërë juve, për shembull,  
18 kur keni shkuar në Prapashticë?

19 Pë. Nuk mund të jem i saktë definitivisht, po unë e mendoj që  
20 Bexhet Vitia ka pasë mundësinë ta përfundojë gjeneratën, sepse  
21 lufta nuk ka fillu në Marec. Lufta ka fillu në Prapashticë,  
22 problemet kanë qenë në Prapashticë, jo në Marec dhe ai s'ka  
23 pasë arsye ta lëshojë qendrën stërvitore dhe të shkojë në  
24 Marec. Por nuk jam i saktë, nuk muj 100 për qind me kanë i  
25 saktë. Sepse ka qenë komandanti ai që e ka vendos kush, ku me

1 shkue.

2 Py. E kuptoj këtë. A është përfundimi juaj që z. Vitia ka  
3 qëndruar në qendrën stërvitore deri më datë 15 prill? Këtë po  
4 thoni?

5 Pë. Unë e mendoj që --

6 Py. Ju kërkoj ndjesë. Pra, përfundimi juaj është një opinion  
7 që mbështetet në atë çfarë keni vënë re apo në atë çfarë ju  
8 besoni se ka qenë situata në atë kohë?

9 Pë. Unë nuk mund të them 100 që ka ndodhë që edhe Bexhet  
10 Vitia e ka lëshue qendrën stërvitore më 7 prill. Unë mendoj që  
11 ai e ka përfunduar deri në fund. Sepse ka qenë i atij fshati.  
12 Edhe nuk ka pasë arsye të largohet prej qendrës stërvitore,  
13 sepse s'ka pasë luftime në Marec më 7 prill.

14 Py. Lidhur me lëvizjet tuaja ose udhëtimet në Prapashticë,  
15 unë e kuptoj që ato kanë filluar më datën 7 prill. Pra, ju  
16 shkuat nga Zllashi, nga qendra stërvitore në Prapashticë,  
17 kështu ishte?

18 Pë. Po.

19 Py. Përmendët që luftimet e ofensivës në Prapashticë kanë  
20 filluar më 7 prill, kështu?

21 Pë. Po.

22 Py. Si ishin ditët përpara datës 7 prill? Si ishte situata  
23 gjatë atyre ditëve?

24 Pë. Para 7 prillit ka qenë gjithçka normale. Nuk po them  
25 gjithçka normale se ne e kena pritë, jemi në gjendje lufte. Po



- 1 në krahasim me 7 prillin ka qenë diçka krejt kontro, krejt  
2 ndryshe. Ditë më e vështirë ka qenë 7 prilli e tutje.  
3 Py. Ajo çfarë doja të thoja ishte në qoftë se kishte  
4 përgatitje në zonë, në mënyrë që të ishte një gjendje  
5 gatishmërie luftarake, këtë po doja të pyesja?
- 6 Pë. Po atje kanë qenë disa njësi, nëpër lagje, nëpër fshatra  
7 kanë qenë prezent. Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka qenë  
8 prezent edhe para 7 prillit në Prapashticë edhe në disa  
9 fshatra tjera. Por me fillimin e luftës, brigada e ka pa të  
10 arsyeshëm, që të më dërgojë mua atje si komandant i batalionit  
11 që t'i unifikoj ato njësi dhe të futen në një komandë kështu  
12 që luftimet të jenë ma nën kontroll.
- 13 Py. Në mënyrë që të merrej pjesë në luftime më datën 7, kur u  
14 larguat juve në fakt nga Zllashi.
- 15 Pë. Nga Zllashi definitivisht jam largu më 10 prill dhe ma  
16 s'jam kthy ma në Zllash.
- 17 Py. Ajo çfarë doja të dija ishte që kur shkuat në Prapashticë  
18 më datën 7, në çfarë kohe u larguat nga Zllashi? Ishte gjatë  
19 natës ndërmjet datës 6 dhe 7? Ishte herët mëngjes më datë 7?  
20 Kur jeni largu nga Zllashi?
- 21 Pë. Gjatë natës.
- 22 Py. Pra, gjatë natës ndërmjet datës 6, 7?
- 23 Pë. Para mëngjesi. Po. Do të thotë në mëngjes po ka qenë  
24 errët koha jo dritë.
- 25 Py. Sa larg është Prapashtica nga Zllashi?

- 1 Pë. Saktësisht nuk e di. Kështu kena ec një orë e gjysëm.  
2 Mund të them 10 kilometra. Nuk jam i saktë. A u kthyet  
3 mbrapsht në Zllash nga Prapashtica të njëjtën ditë?  
4 Pë. Natën po.  
5 Py. Pra, shkuat nga Zllashi në Prapashticë dhe u kthyet nga  
6 Prapashtica mbrapsht në Zllash të njëjtën ditë; kështu?  
7 Pë. Po.  
8 Py. Pra, kur mbërritët në Zllash çfarë bëtë? Fjetët aty,  
9 qëndruat aty gjatë natës?  
10 Pë. Po.  
11 Py. Keni fjetur në qendrën stërvitore?  
12 Pë. Po.  
13 Py. Po pastaj kur u larguar përsëri për të shkuar në  
14 Prapashticë?  
15 Pë. Prapë në mëngjes herët. Sepse forcat serbe nuk u larguan.  
16 Ato veç filluan të pozicionohen.  
17 Py. Në rregull. A është e drejtë të them që ke qëndruar vetëm  
18 disa orë në Zllash gjatë natës apo jo?  
19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
20 Ndoshta mund ta bësh ndryshe pyetjen?  
21 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Po.  
22 Py. Sa kohë qëndronit keni qëndruar në Zllash në qendrën  
23 stërvitore gjatë natës?  
24 Pë. Po nuk muj me ditë me orë, po mund të them që i kam bë  
25 tre-katër orë gjumë.

1 Py. Në rregull. E kuptoj. Atëhere më lejoni të shikoj në  
2 qoftë se kam përfunduar me këtë temë apo jo.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.  
4 Prokurore, kemi ende pesë minuta në dispozicion përpara sesa  
5 të bëjmë një pushim prej 15 minutash.

6 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Po. Ndoshta mund ta bëjmë tani  
7 pushimin. Në mënyrë të tillë që shikoj edhe njëherë pyetjet e  
8 fundit dhe të kaloj pastaj në një temë tjetër dhe nuk është se  
9 më ka ngelur shumë për të pyetur.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë.  
11 Shumë faleminderit.

12 Z. Dëshmitar, tani do të bëjmë një pushim prej 15  
13 minutash. Znj. Sekretare, do t'ju shoqërojë për të dalë nga  
14 salla. Dhe do takohemi përsëri për disa minuta. Faleminderit.

15 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë  
17 mirë. Atëhere do të bëjmë pushim për 15 minuta. Do të takohemi  
18 përsëri në sallë në orën 15.25.

19 Seanca ndërpritet këtu.

20 --- Pauza fillon në orën 15.12

21 --- Seanca fillon në orën 15.25

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë  
23 se jeni rikthyer. Shoh të pranishmit, jemi me të njëjtën  
24 përbërje të ekipeve. Znj. Asistente e sallës, ju lutem  
25 shoqërojeni dëshmitarit të hyjë në sallë.

1 Do të vazhdojmë deri në orën 16.00.

2 [Dëshmitari vijon dëshminë]

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë  
4 se u kthyet Z. Halimi. Tani do të vazhdojmë me pyetjet e  
5 Prokurorisë deri në orën 16.00, për gjysmë ore. Do të shohim  
6 se deri në çfarë pike do të arrijmë pastaj në orën 16.00.

7 Znj. Prokurore, keni juve sërish fjalën.

8 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar  
9 Gjykatës.

10 Py. Z. Halimi, përpara pushimit po diskutonim për kohën që ju  
11 keni qëndruar në qendrën stërvitore në periudhën nga data 7  
12 deri në datën 10, ndërkohë që shkonit nga Zllashi në  
13 Prapashticë dhe ktheheshit nga Prapashtica në Zllash, përsëri.

14 Ju thatë, në përgjigje të pyetjes që bëra unë, lidhur me  
15 kohën që qëndronit ju gjatë natës në Zllash në qendrën  
16 stërvitore, ju thatë që:

17 "Nuk mund ta them ekzaktësisht në orë, por mund t'ju them  
18 që kam fjetur për 3 deri në 4 orë".

19 A ishte kjo e gjithë koha që qëndronit çdo natë në  
20 qendrën stërvitore ato ditë në Zllash?

21 Pë. Po.

22 Py. A është e drejtë të them që, nuk kishit mundësi të dinit  
23 se çfarë ndodhte ato ditë në qendrën stërvitore, për aq kohë  
24 që s'kishit qenë aty?

25 Pë. Unë mund të them që gjithçka ka shkuar në rregull, dhe

1 ato ditë që s'kam qenë unë. Kolegët që kanë qenë prezent, ato  
2 kanë punuar sipas planit të tyre. Dhe trajnimet kanë vazhduar.  
3 Py. E kuptoj këtë. Pyetja ime ka të bëj me faktin që ju  
4 personalisht nuk mund ta dinit, për faktin që nuk ishit i  
5 pranishëm në qendrën stërvitore në ato ditë. Ju nuk mund ta  
6 dinit me saktësi se çfarë ndodhte atje kur s'ishit. A është  
7 kështu?

8 Pë. E saktë. Por po e përsëris që nuk ka ndodh asgjë.

9 Py. E kuptoj. Pyetja ime ishte kjo, përderisa nuk keni qenë i  
10 pranishëm aty, nuk mund ta dinit se çfarë ndodhte gjatë  
11 ditëve, apo jo?

12 Pë. Po.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.  
14 Dëshmitar, ju lutem hiqini dëgjueset.

15 Z. VON BONE: [Përkthim] Lidhur me faktin që nuk e dinte.  
16 Nuk e dinte vetë, por ndoshta ka folur me të tjerët ose  
17 ndoshta mund të kishte marrë vesh nga të tjerët diçka.  
18 Thjeshtë këtë doja të ngrija.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju  
20 kuptoj.

21 Z. VON BONE: [Përkthim] Sa për ta përmbledhur këtë  
22 pjesën.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.  
24 Prokurore, do ju sugjeroja që ta bënit edhe këtë pjesë të  
25 pyetjes.

1 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Po, e nderuar Gjykatëse.

2 Py. Z. Halimi, gjatë atyre ditëve kur ju nuk ishit vetë në  
3 qendrën stërvitore gjatë ditës, nga e dinit nga e merrnit vesh  
4 ju se çfarë kishte ndodhur në qendër, në qoftë se nuk ishit  
5 vetë i pranishëm aty?

6 Pë. Unë e kam cekë ma herët që çdoherë ka qenë kujdestaria,  
7 çdo 24 orë ka kujdestaru dikush. Edhe unë deri më 10 prill kam  
8 qenë komandant i asaj qendre. Është dasht, sipas rregullave,  
9 që të raportohet për gjendjen në qendrën stërvitore dhe kështu  
10 ka ndodh.

11 Py. A keni pasur mundësi që të flisni me dikë që ishte në  
12 kujdestari atë ditë, që ishte përgjegjës në atë ditë?

13 Pë. Po.

14 Py. Kur ka ndodhur kjo?

15 Pë. Në çdo orë kur kam shkuar, jam takuar. Se kujdestari deri  
16 në ora 12 ka pas të drejtë të flejë. Nga ora 12 ka fjetë  
17 ndihmësi i tij. Unë e kam gjetur të zgjuar oficerin kujdestar.

18 Py. Dhe çfarë bisede ose çfarë informacioni keni marrë ju nga  
19 personi që ishte në detyrë? Që ishte kujdestar?

20 Pë. Thjesht stërvitjet gjatë ditës.

21 Py. Personi kujdestar, a raportonte se si kishte shkuar  
22 trajnimi?

23 Pë. Po.

24 Py. A keni pasur mundësi që vetë të shikonit shënimet që  
25 mbaheshin ose në fletore, ose në regjistra, në qendrën

1 stërvitore gjatë atyre pak orëve kur jeni kthyet aty?

2 Pë. Po.

3 Py. Si bëhej kjo? Shkoje atje? Ju lutem, a mund të na e  
4 përshkruani se çfarë ndodhte? Çfarë ndodhte në momentin kur ju  
5 ktheheshit në Zllash gjatë natës, gjatë periudhës së natës në  
6 atë kohë?

7 Pë. Unë këtë rrugë e kam ba me qëllim që duke menduar që  
8 forcat serbe nuk do të vendosen, do të vinë në fshat por do të  
9 kthehen. Ka ndodhur shumë raste në Kosovë që kanë hy dhe kanë  
10 dalë brenda nja ditë, dy. Nuk janë pozicionuar. Edhe arsyeja,  
11 qëllimi im ka qenë që të mos e lëshoj qendrën stërvitore deri  
12 në fund, deri me 15 prill. Por ka qenë e pa mundur dhe kështu  
13 që veç kam ba rrugë kot se ashtu kështu është dash të shkoj në  
14 Prapashticë edhe mos kthehem ma.

15 Py. E kuptoj këtë. Ju pyeta se çfarë kontrollesh bëje, çfarë  
16 shikoje kur ktheheshe nga Prapashtica për në Zllash?

17 Pë. Oficeri kujdestar e ka pas nja fletore. Në atë fletore  
18 është dasht të shënohet gjithçka çka është punuar tërë ditën.  
19 Në cilën orë është ba, çka mundur, si ka shkuar aktiviteti  
20 gjatë tërë ditës. Edhe unë thjesht e kam lexuar çdoherë atë  
21 raport të kujdestarit. Por, ma ka thanë edhe gojarisht nëse ka  
22 pas diçka të veçantë për me e thanë. Por nuk ka pasur gjë. Ka  
23 shkuar gjithçka në rregull edhe pse s'kam qenë unë. Do të  
24 thotë, nuk pas pasur ndonjë eksen ndonjë problem apo mos  
25 shkojë trajnimi mirë. Por gjithçka ka shkuar në rregull.

1 Py. E kuptoj. Por, mos pasja e këtyre regjistrave apo  
2 shënimeve, a jeni dakord me mua kur them unë që është shumë e  
3 vështirë për të mbajtur mend me saktësi çdo gjë që ishte  
4 hedhur në ato shënime dhe çdo gjë që kishte ndodhur?

5 Pë. Bindur ma dëshirë i kisha pasur nëse jo, po t'i kishim  
6 ato shënime. Sepse më kishin mbet kujtime të shkruara për  
7 jetë. Do të thotë, shumë ma dëshirë do të kisha pasur t'i  
8 kisha ato sot këtu e t'i dëshmoja pranë juve. Por, për fat të  
9 keq nuk i kam.

10 Por këtë që po ta them, me plot përgjegjësi po ta them,  
11 që unë po them të vërtetën.

12 Py. Po. Por pyetja ime është kjo, pa shënimet pa regjistrat,  
13 si mund të jesh i sigurt që i mban mend të gjitha gjërat që  
14 kanë ndodhur apo që nuk kanë ndodhur gjatë asaj kohe, gjatë  
15 asaj periudhe kur nuk keni qenë i pranishëm aty?

16 Pë. Gjërat që përjetohej nuk harrohen kurrë. Ato i kam  
17 përjetuar, i kam parë edhe s'do t'i harroj kurrë. Të sigurt,  
18 Prokurore, s'e kena pas as ne jetën. E mos them regjistrat  
19 librat fletoret. As jeta ime s'ka qenë e sigurt. Kështu që për  
20 mua është me thanë, për ju është me besu ose mos me besu.

21 Py. E kuptoj z. Dëshmitar. Por, po diskutojmë ekzaktësisht  
22 gjërat të cilat ju nuk i keni parë me sytë tuaj, se nuk keni  
23 qenë i pranishëm aty?

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të  
25 vazhdojmë tani.



1 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit të nderuar  
2 Gjykatës.  
3 Py. Z. Dëshmitar, si mund të përjashtoni që, në qoftë se nuk  
4 ju është raportuar diçka, ajo gjëja nuk ka ndodhur?  
5 Pë. S'ka mund të përshkruhet diçka që ka ndodhë e të mos  
6 përshkruhet. Nuk ka ndodhë asgjë diçka e keqe. Gjithçka ka  
7 shkuar në rregull sipas plan-programit. Edhe njëherë po e  
8 përsëris, oficeri kujdestar ka qenë i obliguar ta përshkruajë  
9 gjendjen për 24 orë. Deri më 10 prill unë kam qenë komandant i  
10 qendrës stërvitore dhe ato është dasht të më raportojnë mua.  
11 Kjo është e tëra.  
12 Py. E kuptoj. Por, si mund të jeni i sigurt që çdo gjë ju  
13 është raportuar? Që të gjitha gjërat ju janë raportuar?  
14 Pë. Të sigurt s'e kemi as jetën sa jetojmë. Domethënë, unë  
15 s'mundem me ta thanë 100% sa jam i sigurt. Por, po ju them ato  
16 që kam lexuar dhe që e kam pa. Tash ti mundesh me më ba pyetje  
17 20 herë, por përgjigja ime është kjo.  
18 Py. Në rregull. Faleminderit që na e sqaruat.  
19 Z. Halimi, sot juve iu bë një pyetje se si e njihni z.  
20 Salih Mustafa. Kjo është pyetje e bërë në faqen 50. Në  
21 përgjigje të kësaj pyetje ju thatë, dhe po lexoj nga faqja 50,  
22 rreshtat nga 20 deri në 22:  
23 "Unë nuk e njihja Calin nga më përpara. Por gjatë luftës  
24 njihja vetëm pseudonimin Cali. Por, unë nuk kam pas kontakte  
25 me të sepse zinxhiri i komandës ishte i veçantë. Por, kam

1 dëgjuar për të".

2 Më tej ju kërkua që të sqaronit zinxhirin e komandës që  
3 ishte i veçantë.

4 Gjithsesi, unë dua që t'i kthehem sërish kësaj pyetje,  
5 sepse nuk mendoj që pyetja që ju bë, mori përgjigjen e  
6 nevojshme.

7 Ju thatë:

8 "Unë kam qenë komandant i qendrës stërvitore dhe  
9 raportoja përpara Brigadës 153".

10 Ju bë pyetje tjetër, në qofte se Z. Mustafa ka qenë pjesë  
11 e Brigadës 153 dhe në përgjigje ju thatë, "Jo". E mbani mend  
12 këtë?

13 Pë. Po, e mbaj mend.

14 Py. A mund të na tregoni se si e keni njohur z. Mustafa gjatë  
15 luftës.

16 Pë. Calin e kam njohur me pseudonimin Cali. Edhe prej të  
17 tjerëve kam kuptuar që ky është komandant i BIA-s. Deri sa kam  
18 punuar në Trupat Mbrojtëse të Kosovës edhe emrin s'ja kam dit.  
19 Mbas lufte kemi punuar në Trupat e Mbrojtjes së Kosovës, TMK.  
20 Unë kam punuar në akademinë e mbrojtjes, ai ka punuar në zonën  
21 e 5 mbrojtje.

22 Py. Në rregull. Pra, gjatë luftës juve e njihnit atë si Cali,  
23 apo jo?

24 Pë. Po.

25 Py. Dhe ju thatë:

1            "...nga të tjerët e kishit kuptuar që ai ishte komandant  
2 i BIA-s".

3            Po lexoj nga rreshtat 2 deri në 3 të faqes 97.

4            Së pari më lejoni t'ju pyes, kur e kuptuat ju se ai ishte  
5 komandant i BIA-s?

6            Pë. Saktësisht nuk e di, nuk e di kur. Veç e kam kuptuar.

7            S'mund me ta dhanë një datë të saktë, sepse nuk e kam

8 apostrofu në kokën time këtë punë. Nuk i kam dhanë shumë

9 rëndësi ta futi në memorien time ose kur e qysh. Por, kështu e  
10 kam dëgju.

11            Py. Në rregull. A ju kujtohet se kur e keni takuar për herë  
12 të parë atë gjatë luftës?

13            Pë. Mund të them që jemi takuar një herë a dy, një

14 përshëndetje. Por jo gjatë. Nuk kam pas kontakt me zgjat

15 bisedë. Vetëm thjesht një përshëndetje. Edhe pse kam pas

16 respekt ndaj tij, sepse sipas informatave që kam pas, ai ka

17 qenë dhe ish i burgosur politik në një moshë shumë të re.

18            Kështu që unë kam pas respekt.

19            Py. Kjo ka ndodhur gjatë periudhës kur ju keni qenë në Kosovë  
20 në vitin 1999?

21            Pë. Për çka e ke fjalën?

22            Py. Ju thatë që: "Mund të jemi takuar një herë ose dy herë. E  
23 kam përshëndetur".

24            Pë. Po, po.

25            Py. Pra, thjesht po mundohesha që të kuptoja se kur ka

1 ndodhur kjo.

2 Pë. Po, po.

3 Py. Kjo periudha është nga mesi i janarit deri në prill të  
4 vitit 1999? E saktë është kjo?

5 Pë. Po.

6 Py. A ju kujtohet se ku ka ndodhur kjo?

7 Pë. Jo.

8 Py. Në atë periudhë ju keni qenë në Zllash, apo jo?

9 Pë. Po.

10 Py. Ka ndodhur që jeni takuar me Z. Mustafa në Zllash?

11 Pë. Rrugës jena takuar, po.

12 Py. Çfarë doni të thoni me "rrugës"?

13 Pë. Po, rrugëkalim. Diku rrugës. Jo në objekt, jo në brigadë,  
14 por gjatë rrugës.

15 Py. E keni fjalën që, jo brenda qendrës stërvitore ku po  
16 qëndronit?

17 Pë. Jo. Jo, në qendrën stërvitore.

18 Py. Jo, në qendrën stërvitore, jo, në objektin e brigadës?

19 Besoj bëhet fjalë për Brigadën 153?

20 Pë. Po nuk mund --. Ta ceka ma herët, që nuk e kam  
21 paramenduar ta mbaj mend ose në memorie se kur dhe qysh. Po  
22 thjesht e kam takuar njëherë a dy edhe ka qenë një  
23 përshëndetje, asgjë tjetër.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.

25 Prokurore. Që ta kuptoj unë.

1 Z. Dëshmitar, kur thoni që jam takuar "rrugës", çfarë  
2 doni të thoni me këtë? Sepse më duket pak e paqartë.

3 DËSHMITARI: Ai -- po them ato që edhe ka qenë. Dhe unë --  
4 Ka ndodh njëherë a dy, që ishim taku rrugës.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ku  
6 rrugës?

7 DËSHMITARI: Në Zllash.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pra,  
9 mund ta thoni që, e takova në Zllash në rrugë. Se na shkoi 10  
10 rreshta përkthim. Në fakt e di që ka qenë një ditë e gjatë,  
11 kemi gjithë ditën këtu. Por përpiquni të përqendrohni tek  
12 pyetjet.

13 Znj. Prokurore, keni fjalën.

14 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar  
15 Gjykatës.

16 Py. Thatë një herë a dy herë. Vetëm kaq jeni takuar me të?  
17 Nja dy herë gjatë kësaj periudhe?

18 Pë. Një herë. Më duket njëherë, dy.

19 Py. Asokohe kur e keni taku dhe thatë që thjesht jeni  
20 përshëndet, a e dije ti çfarë roli kishte ai në UÇK?

21 Pë. Në atë moment s'e kam dit. Por e kam kuptuar prej shokëve  
22 të tjerë rolin e tij. Se ai normal që s'ma ka thanë që unë jam  
23 ky, ky, ky. Ose anasjelltas me fytyrën e atij.

24 Py. Po. Asokohe kur jeni takuar nuk e dinit se kush ishte,  
25 por prej shokësh e morët vesh se çfarë roli kishte.

1 Kush të tregoi për rolin e tij?

2 Pë. Unë e kam pas një shok në brigadë, ka qenë edhe ai i  
3 burgosur politik. Edhe ai na ka treguar që edhe ai ka qenë në  
4 burg me të.

5 Py. Ndonjë gjë tjetër?

6 Pë. Jo.

7 Py. A të tregoi se çfarë roli kishte z. Mustafa atëherë?

8 Pë. Po.

9 Py. Çfarë të tha?

10 Pë. Ai më ka tregu se Salih Mustafa ka qenë i burgosur  
11 politik edhe Salih Mustafa është komandant i BIA-s. Ai shok që  
12 mi ka tregu mua, ka qenë Rrahman Dini. I cili ka qenë në burg  
13 me të. Ai më ka thënë që, ky ka qenë në burg në moshë shumë të  
14 re dhe ka qenë i burgosur politik.

15 Py. Po, në rregull. Pra, mësuat kur ishit në Zllash se  
16 personi, të cilin ju e njihnit me emrin Cali, ishte komandant  
17 i BIA-s. Po emrin dhe mbiemrin, emrin plotë përveç se që i  
18 dinit këtë nofkën apo emrin shkurt Cali, a e dinit atëherë?

19 Pë. Jo.

20 Py. Pra, e dinit që Cali ishte komandant i BIA-s. Kur thatë  
21 sot se, "Nuk kam pasur kontakte me të, se linja e urdhreve e  
22 komandimit e vartësisë ishte më vete", e kishit fjalën për  
23 linjën e vartësisë të Brigadës 153 dhe të BIA-s?

24 Pë. Qëllimin e kam pas në atë aspektin e hierarkisë. Unë i  
25 kam dhanë llogari Brigadës 153, kam qenë vartës i Brigadës

- 1 153. Edhe mua s'më ka ra me pyet ose me dit se Cali çfarë  
2 funksioni ka. Nuk kam qenë një person që është dashtë ose kam  
3 pas të drejtë të hulumtoj kush është, çka është.
- 4 Py. Po. Por, pyetja ime ishte nëse e kishit fjalën për faktin  
5 se Brigada 153 dhe BIA kishin një linjë vartësie më vete. A e  
6 thatë këtë më herët sot?
- 7 Pë. Po. Brigada ka qenë vartësi më vete. BIA ka qenë vartësi  
8 më vete. Të dyja kanë qenë nën komandën e zonës operative të  
9 Llapit.
- 10 Py. Çfarë dinit ju për BIA-n?
- 11 Pë. Nuk di shumë.
- 12 Py. Dinit nëse kishte bazë në Zllash? E kam fjalën për BIA-n.
- 13 Pë. Jo. Nuk e kam dit.
- 14 Py. Por z. Mustafa e keni parë në Zllash, apo jo?
- 15 Pë. Po.
- 16 Py. Çmendonit ju se bënte ai aty?
- 17 Pë. Mua s'më ka interesu me hulumtu se çka ban Cali. As atij  
18 s'i ashtë dash me u interesu për mua. Secili i kena pas  
19 detyrat tona. S'ka qenë koha të merremi kush, çka ban. Qëllimi  
20 im ka qenë me stërvit ushtarë sa më shumë edhe me krye detyrën  
21 time për çka kam ardh. Sepse kam ba mbi 2 mijë kilometra për  
22 me ardh në luftë. Kështu që ma shumë jam marrë me punët e  
23 mija.
- 24 Py. Po. Ta them ndryshe pyetjen. Nuk të interesonte të dije  
25 se çfarë bënë njësitet e UÇK-së në vendin ku ti ishe komandant

1 i një qendre stërvitore?

2 Pë. Jo. Sepse unë...

3 Py. Po thoni se nuk kishit asnjë informacion se çfarë po  
4 ndodhte në pjesën tjetër të fshatit, të Zllashit?

5 Pë. Jo, s'kam pas.

6 Py. A keni punuar së bashku me Z. Mustafa ndonjëherë pas  
7 lufte?

8 Pë. Jo. Në Trupat Mbrojtëse të Kosovës, po. Por jo në  
9 komandë. Komanda të ndryshme.

10 Py. Po. Të dy keni qenë në Trupat Mbrojtëse të Kosovës, apo  
11 jo?

12 Pë. Po.

13 Py. A keni pas mundësi që të njiheshit më mirë me z. Mustafa  
14 gjatë kohës që keni qenë në Trupat Mbrojtëse të Kosovës?

15 Pë. Po.

16 Py. Keni folur me të? Keni shkëmbyer informacione lidhur me  
17 periudhën tuaj në UÇK, fjala bie?

18 Pë. Me Calin, edhe me shumë shokë të tjerë, na ka lidh shumë  
19 edhe tubimi përkujtimi i dëshmorëve të Gollakut. I cili është  
20 ba për çdo vit më 18 prill. Aty na ka bashku, jo vetëm me  
21 Calin, por edhe me shumë shokë të tjerë.

22 Py. Dhe sa kohë keni punuar në Trupat Mbrojtëse të Kosovës?

23 Pë. Kam punuar deri në 2010.

24 Py. Sa shpesh keni mbajtur kontakte me z. Mustafa gjatë kësaj  
25 periudhe? Pas luftës.



1 Pë. E thashë ma herët. Me Calin edhe më shumë shokë të tjerë,  
2 na ka bashkuar ndonjë përkujtim i dëshmorëve. Edhe sidomos në  
3 Viti të Marecit, ku atje për çdo vit është mbajt epopeja e  
4 Marecit. Ku ka pas shumë të rënë dëshmorë. Aty jo vetëm me  
5 Calin, por edhe me shumë shokë të tjerë na ka bashku ai vend.  
6 Edhe mbetet prapë të na bashkoi ai vend.

7 Py. Z. Mustafa, jua dinte pseudonimin që keni pasur atëherë?

8 Pë. Cali, s'e ka dit as ky emrin tim gjatë luftës. Mbas  
9 luftës sigurisht që e ka kuptuar. Se dhe Cali e ka dit që unë  
10 quhem Llapi. Jo me emër dhe mbiemër.

11 Py. Po numrat e telefonit, ja kishit njëri-tjetrit gjatë  
12 luftës? Pra, ju dhe z. Mustafa?

13 Pë. Për fat të keq, gjatë luftës s'kena pas telefon fare.

14 Py. Jo, më falni. E thashë unë gabim. Pas luftës.

15 Pë. Po. Po e përsëris edhe njëherë, meqë 3-4 herë ma ban të  
16 njëjtën pyetje. Nuk kam pas. Jo që s'kam dash, por s'kam pas  
17 mundësi të takohem me të. Se me gjithë respektin, isha takuar  
18 për çdo ditë me të. Por, puna na ka nda. Unë kam punuar në  
19 komandën e Trajnimit të Doktrinës, kam jetuar në fshat edhe  
20 kështu që ka qenë e pamundur unë të kontaktoj me shumë njerëz.

21 Py. Por, po e përsëris meqë pyetja ime nuk ishte e qartë. Se  
22 në fillim thashë gjatë luftës. Por në fakt pyetja është kjo,  
23 pas lufte a e keni pasur numrin e telefonit njëri-tjetrit?

24 Pë. Jo.

25 Py. A do të habiteshit po ta dinit që emri juaj del në

1 adresarin, në listën e emrave dhe të numrave që janë gjetur në  
2 telefonin e z. Mustafa?

3 Pë. Nuk më kujtohet. Por, edhe me dalë nuk është diçka --  
4 është edhe normale. Nuk ka qenë diçka e ndaluar ta kem edhe  
5 numrin e tij ose të bisedoj me të.

6 Py. Jo, nuk po flasim për gjëra që janë të ndaluara apo jo të  
7 ndaluara. Z. Halimi, thjesht ju pyeta nëse keni apo jo numrin  
8 e telefonit të njëri-tjetrit. Por po thoni që...

9 Pë. Nuk më kujtohet.

10 Py. ...që nuk ju kujtohet nëse ju dhe z. Mustafa ja keni  
11 numrin e telefonit njëri tjetrit. Kështu po thoni?

12 Pë. Po, nuk më kujtohet.

13 Py. Por në fakt i kemi.

14 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, është  
15 dokumenti me numër SPOE00325983. Nuk e shoh të nevojshme që ta  
16 nxjerrim në ekran. Mbase edhe mund ta nxjerrim, sepse është  
17 thjesht një fotografi ekрани. Prandaj ju lutem që të nxjerrim  
18 në ekran dokumentin me numër SPOE00325983.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po.  
20 Vetëm se po i afrohem orës 16.00 dhe do të doja që ta  
21 mbyllnim në këtë orë.

22 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Ta kryejmë këtë dhe do ta  
23 mbyllim për sot.

24 Ju lutem që të zmadhojmë shënimet.

25 Py. Pra, ju këtu jeni regjistruar me emrin "Llapi i

Dëshmitari: Musli Halimi (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga znj. D'Ascoli

Faqe 115

1 Gollakut". A mund të na thoni nëse ky numër që është në  
2 rreshtin e parë, tek shtylla që thotë "Entries" [fonetike] në  
3 anglisht, hyrje. Nuk ka nevojë që ta lexoni, thjeshtë të thoni  
4 a është numri juaj apo jo?

5 Pë. Po.

6 Py. Po, në kuptimin që është numri juaj i telefonit?

7 Pë. Po.

8 Py. Thjesht ja kërkova që të regjistrohet në procesverbal.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

10 Dëshmitar, a është ky numri i juaj i telefonit, kjo që është  
11 shkruar këtu?

12 DËSHMITARI: Po.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A

14 mund të thoni: po, ky është numri im i telefonit?

15 DËSHMITARI: Po.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E

17 keni të vështirë të thoni që: po, ky është numri im i

18 telefonit? A më kupton?

19 DËSHMITARI: Po. Ky është numri im i telefonit. Po, po.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

21 Faleminderit.

22 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Në rregull.

23 Py. Z. Halimi, mos po përpiqeni që ta minimizoni njohuritë që

24 keni për z. Mustafa?

25 Pë. Jo. Por s'mu ka kujtu që unë ia kam dhanë numrin ose ma

Dëshmitari: Musli Halimi (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga znj. D'Ascoli

Faqe 116

1 ka dhanë. Është e pamundur që të mbaj mend gjithçka.

2 Py. Në rregull.

3 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, është  
4 momenti për të ndaluar këtu se është ora 16.00. Nuk kam edhe  
5 shumë të tjera. Mbase edhe 10 minuta më kanë mbetur për nesër.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
7 Faleminderit, znj. Prokurore.

8 Të shohim se si jemi me kohën.

9 Znj. Mbrojtëse e Viktimave, do të keni pyetje nesër për  
10 dëshmitarin?

11 ZNJ. VOSENBERG: [Përkthim] Po, të nderuar Gjykatës. Por  
12 jo shumë.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
14 Përafërsisht ndonjë vlerësim të kohës së nevojshme?

15 ZNJ. VOSENBERG: [Përkthim] Pesë, dhjetë minuta. Jo më  
16 shumë se atë.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
18 Faleminderit.

19 Z. Avokat i Mbrojtjes, dëshironi që të bëni pyetje  
20 plotësuese këtij dëshmitari?

21 Z. VON BONE: [Përkthim] Shumë pak, mendojmë.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Është  
23 mirë ta dimë për planifikimin. Faleminderit.

24 Z. Dëshmitar, ju falënderojmë për dëshminë juaj sot. Do  
25 të vijojmë nesër në mëngjes. Besoj se duhet të mbarojmë në

1 sesionin e parë. Ju rikujtoj që të mos diskutoni me askënd sa  
2 i takon dëshmisë suaj këtu, këto që i keni thënë para Trupit  
3 Gjykues. Asistentja e sallës do t'ju shoqërojë të dilni nga  
4 salla dhe ju uroj një mbrëmje të këndshme.

5 DËSHMITARI: Faleminderit.

6 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

8 Faleminderit znj. Asistente e sallës.

9 Atëherë, palët dëshirojnë të ngrenë ndonjë gjë? Nuk e di  
10 Mbrojtësja e Viktimave? Avokati i Mbrojtjes, dëshiron të  
11 ngrejë ndonjë çështje para Trupi Gjykues? Jo. Në rregull.

12 Përpara se të bëjmë ndërprerjen e seancës këtu, i lutem  
13 Sekretares të Gjykatës të na kalojë shumë shkurt në seancë  
14 private.

15 [Seancë private]

16 [Seancë private teksti i fshirë]

17

18

19

20

21

22

23

24

1 [Seancë e hapur]

2 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
3 jemi sërish në seancë publike.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
5 Faleminderit, znj. Sekretare.

6 Do të rifillojmë nesër në orën 9.30. Do të vijojmë me  
7 dëshminë e Dëshmitarit 1300. Me të mbaruar me Dëshmitarin  
8 1300, do të vazhdojmë me dëshminë e Dëshmitarit 1400.

9 Këtu ndërpritet seanca për sot.

10 --- Seanca mbyllet në orën 16.05

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25